



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Universitetit “Ismail Qemali”
Vlorë
Maj 2017**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1	Alison Blackburn	Kryetare
2	Profesor Mark Davies	Anëtar
3	Profesor Raimonda Duka	Anëtare
4	Profesor As. Eglantina Hysa	Anëtare
5	Profesor Chris Maguire	Anëtar
6	Dr. Carol Vielba	Anëtare

Datë: 18-19 Maj 2017

Alison Blackburn

Mark Davies

Raimonda Duka

Eglantina Hysa

Chris Maguire

Carol Vielba

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi	1
Konteksti i këtij vlerësimi.....	2
Raporti i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve	4
Raporti i detajuar	6
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	6
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	11
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	16
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi	19
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	24

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i këtij Vlerësimi Institucional është të vlerësojë shkallën deri ku çdo IAL ka përmbushur Standardet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm ku çdo grup vlerësimi përbëhet nga një kombinim ekspertësh britanikë caktuar nga QAA (Quality Assurance Agency – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë) dhe ekspertë shqiptarë caktuar nga APAAL (Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën deri ku IAL-ja përmbush Standardet, por edhe do të informojnë IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si çdo IAL përmbush Standardet. Ky raport ndihmon gjithashtu edhe IAL-në të identifikojë prioritetet për rritjen dhe zhvillimin (proces nëpërmjet të cilit, ofruesit e arsimit të lartë përmirësojnë në mënyrë sistematike cilësinë e ofrimit dhe rrugët në të cilat mbështetet të mësuarit e studentëve).

Standardet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë janë grupuar nën pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikës së mirë, rekomandimet, pohimet e veprimeve aktuale dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, së bashku me një gjykim se sa mirë IAL-ja i përmbush Standardet. Gjykimet që mund të përcaktojnë ekspertët janë: Standardet janë përmbushur plotësisht; Standardet janë përmbushur kryesisht; Standardet janë përmbushur pjesërisht; ose Standardet nuk janë përmbushur.

Së fundi, vlerësuesit arrijnë në disa përfundime, duke rekomanduar një gjykim përmbledhës për Këshillin e Akreditimit të APAAL-it. Ky gjykim i përgjithshëm është një nga katër nivelet:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Si pjesë të procesit të përpilimit të raportit, QAA-ja ka dhënë mbështetje me ekspertë për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, për të garantuar që Grupi të mbështesë gjetjet e bëra me materiale faktike dhe prova, si dhe duke redaktuar dhe përmbledhur raportin e plotë më poshtë.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” është një universitet publik i themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave në vitin 1944 si Universiteti Teknologjik i Vlorës dhe u riemërua si Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” në vitin 2007. Fakultetet themeluese (i Tregtisë, Inxhinierisë Detare dhe i Infermierisë) u ndërtuan mbi bazë të trashëgimisë më të hershme nga institucione që datojnë në vitin 1919, dhe ekspertizës disiplinore në këto institucione. Që nga viti 1994 Universiteti është rritur në përmasa dhe në ofrimin e lëndëve, në përgjigje të nevojave rajonale të Shqipërisë së Jugut. Tani ka katër fakultete dhe 16 departamente, që ofrojnë programe në të tre ciklet e studimit dhe rreth 200 pjesëtarë të stafit akademik me kohë të plotë. Universiteti karakterizohet nga roli i tij i fuqishëm rajonal dhe rrjetet vendore.

Raporti i përmbledhur

Raporti i Vetëvlerësimit (RVV) u zhvillua nga një grup i Universitetit, i cili përfshinte përfaqësues nga të gjitha fakultetet dhe një përfaqësues i studentëve. Projektraportet, duke u bazuar në raportet e vlerësimit të zhvilluara në secilën fushë, iu shpërndanë një audience të gjerë brenda Universitetit dhe u rishikuan nga Rektori para se të përmbylleshin nga grupi i vetëvlerësimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjeti disa kufizime në prezantimin e raportit, i cili nuk i referohej në veçanti çdo standardi dhe që një sasi e dokumenteve mbështetëse nuk u vu në dispozicion në gjuhën angleze. Përshkrimi i raportit për çdo Fushë Vlerësimi ka qenë i dobishëm për Grupin e Vlerësimit, për të analizuar shkallën në të cilën Universiteti i ka përmbushur Standardet; megjithatë, gjykimet e vetëvlerësimit të Universitetit ishin më pozitive sesa ato të arritura nga Grupi i Vlerësimit.

Vizita u zhvillua gjatë dy ditëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga katër ekspertë britanikë të arsimit të lartë me përvojë, dhe dy anëtarë me përvojë të arsimit të lartë prej stafit të institucioneve shqiptare të arsimit të lartë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i vlerësimit dhe një person i caktuar për mbajtjen e shënimeve, siguruar nga APAAL-i, agjencia përgjegjëse për vlerësimin e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u pajis me një Raport Vetëvlerësimi dhe një dosje të dokumenteve mbështetëse të javë përpara vizitës së vlerësimit dhe u plotësua me dokumentacion shtesë të kërkuar. Në tërësi, u shqyrtuan rreth 255 dokumente që i mundësuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të njihet me strukturën, politikën, procedurat e administrimit dhe natyrën e veprimtarisë mësimor dhe kërkimor të ndërmarrë nga Universiteti. Dokumentet e shqyrtuara përfshinin Statutin e Universitetit, Rregulloret Akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, gamën e marrëveshjeve me jashtë, shembuj të informacionit të programit dhe evidenca nga diskutimet në mbledhjet vendimmarrëse.

Një sërë takimesh u zhvilluan gjatë dy ditëve të vizitës së vlerësimit, gjë që i lejoi Grupit të Vlerësimit të krijonte një pamje më të qartë të përgjegjësive, procedurave dhe pikëpamjeve të stafit dhe studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektoren, drejtuesit e lartë, studentët, pedagogët, stafin administrativ dhe mbështetës dhe aktorët e jashtëm. U mbajtën shënime në të gjitha takimet. Si pjesë e një ture në ambientet e universitetit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët dhe laboratorët e TI-së dhe pati mundësinë të shihte sistemet elektronike dhe online të informacionit të Universitetit në dispozicion të stafit dhe studentëve. Duke shqyrtuar të gjitha dokumentet e disponueshme, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimet e paraqitura më poshtë.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij. Përgjegjësitë për organizimin dhe menaxhimin e Universitetit janë të përcaktuara qartë në Statutin e Universitetit dhe rregulloret dhe funksionojnë komisionet përkatëse, ndërsa Universiteti po punon drejt zbatimit të plotë të legjislationit të ri. U pohuan ngritja e Njesisë së Sigurimit dhe Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, miratimi i një strategjie të re zhvillimi dhe puna që po bëhet për të monitoruar në mënyrë sistematike punësimin e të diplomuarve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha rekomandime dhe nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Universiteti i përmbush pjesërisht standardet për Burimet. Përgjegjësitë për burimet janë të përcaktuara në Statut dhe në rregulloret, dhe kryhen në mënyrë të përshtatshme, nëpërmjet Rektoratit, Senatit dhe Bordit të Administrimit. Universiteti ka në përgjithësi procese të

përshtatshme për menaxhimin e burimeve të veta njerëzore dhe fizike, por efektshmëria i këtyre proceseve është i kufizuar nga kufizimet buxhetore. Ndërsa Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi hapat e ndërmarra nga Universiteti, për të përmirësuar infrastrukturën, rezultatet deri më tani nuk kanë qenë të mjaftueshme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si një dobësi mospërbushjen e standardeve që lidhen me hapësirën dhe gjendjen e ndryshueshme të ndërtesave dhe ambienteve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandoi që Universiteti të ndërmarrë hapa për të siguruar që burimet e tij fizike të jenë në përputhje me standardet shtetërore të kërkuara dhe të sigurojnë cilësinë e mundësive për të mësuarit.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për Kurrikulën. Universiteti ofron programe në të tre ciklet e studimit dhe synon të ofrojë kurrikula që përqendrohen në nevojat e ekonomisë rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Universiteti punon ngushtësisht me punëdhënësit vendas, për të ofruar vende pune dhe vend për zhvillimin e praktikës profesionale, me qëllim rritjen e punësueshmërisë së studentëve të vet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi punën e bërë nga Universiteti për të forcuar shërbimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha rekomandime dhe nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin. Strategjia e ndërkombëtarizimit të Universitetit pasqyrohet në ambiciet e tij të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe, duke marrë parasysh kufizimet e burimeve, në përgjithësi ka pjesëmarrje të lartë në projektet e jashtme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si një dobësi mungesën e një skeme për trajnimin fillimisht të stafit të ri si dhe stafit ekzistues, për të përmirësuar vazhdimisht mësimdhënien e tyre, dhe rekomandoi që Universiteti të zbatojë një sistem të efektshëm dhe procedurën shoqëruese për zhvillimin profesional të të gjithë stafit mësimdhënës në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikën më të mira aktuale. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi hapat që Universiteti ka filluar të ndërmarrë për të adresuar mbështetjen për studuesit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre. Pranimi i studentëve në programe administrohet në përputhje me Statutin dhe rregulloret, dhe studentët (si të ardhshëm, ashtu edhe aktualë) kanë akses në informacione të qarta për programet e studimit dhe shërbimet e Universitetit. një pjesë të madhe mbështetje për studentët ofrohet nga stafi akademik dhe ai administrativ, përfshirë këshillimet e karrierës të ofruara nga Qendra e Këshillimit të Studentëve. Ekziston mbështetja për pjesëmarrjen e studentëve në qeverisjen e Universitetit dhe është themeluar një Këshill Studentor (por ende nuk është plotësisht funksional). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi hapat që po ndërmerr Universiteti për të përmirësuar raportin pedagogë-studentë; hapat që ndërmerren për të rritur dhe pasuruar bibliotekën; dhe ngritjen e Këshillit Studentor. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi, nuk dha rekomandime dhe nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e një skeme si për trajnimin fillimisht të stafit të ri, edhe stafit ekzistues, për të përmirësuar në vazhdimësi mësimdhënien e tyre (pika 4.12, **Kapitulli I, Standardi II.4**)
- pamundësinë për të përmbushur standardet në lidhje me hapësirën dhe gjendjen e ndryshueshme të ndërtesave dhe ambienteve (pika 2.16, **Kapitulli III Standardi V.1**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- universiteti të zbatojë një sistem të efektshëm dhe procedurën shoqëruese për zhvillimin e të gjithë stafit mësimdhënës, për të përfshirë pedagogët e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikat më të mira aktuale (pika 4.12; **Kapitulli I, Standardi II.4**)
- universiteti të ndërmarrë hapa për të siguruar që burimet e tij fizike të jenë në përputhje me standardet e kërkuara shtetërore (**Kapitulli II, Standardi V.1** dhe veçanërisht kriteri 5) dhe të sigurojnë cilësinë e mundësive për të mësuarit (pika 2.16; **Kapitulli III Standardi V.1**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se janë ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- hapat që janë duke u ndërmarrë për të shqyrtuar dhe rishikuar masat për sigurimin e cilësisë dhe standardeve, nëpërmjet krijimit të Njësisë së Sigurimit dhe Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë (pika 1.7, **Kapitulli III Standardi I.4**)
- veprimi në vazhdim e sipër për të zhvilluar dhe miratuar një strategji të re zhvillimi (pika 1.9, **Kapitulli III Standardi I.5**)
- puna në proces për të monitoruar sistematikisht punësimin e të diplomuarve të vet (pika 1.15 dhe 5.16; **Kapitulli III Standardi III.1**)
- puna që po ndërmerret nga Universiteti për të forcuar shërbimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës (pika 3.2, **Kapitulli I Standardi I.2**)
- hapat që Universiteti ka filluar të ndërmarrë për të adresuar mbështetjen ndaj kërkuesve shkencore, që rrjedhin nga plani i veprimit për Strategjinë e Burimeve Njerëzore për Kërkuesit shkencor (pika 4.23, **Kapitulli II Standardi I.8**)
- hapat që po ndërmerren nga Universiteti për të përmirësuar raportin pedagog-student (pika 5.6, **Kapitulli I Standardi III.1**)
- hapat që po ndërmerren për të alokuar buxhetin e bibliotekës, nëpërmjet mekanizmave të buxhetimit të Universitetit dhe për të pasuruar bibliotekën me anë të donacioneve, në mënyrë që të mbështesin në mënyrë të efektshme mësimnxënien dhe kërkimin shkencor të studentëve (pika 5.10, **Kapitulli I Standardi II.5**)
- hapat që po ndërmerren për themelimin e Këshillit Studentor, i cili do të formalizojë dhe përmirësojë komunikimin ndërmjet studentëve dhe organeve vendimmarrëse të Universitetit (pika 5.14; **Kapitulli I Standardi III.7**)

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin institucional janë **përbushur kryesisht.**
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur pjesërisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënie, Mësimnxënie, Vlerësim dhe Kërkim janë **përbushur kryesisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht.**

Gjykimi i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit që në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali" Standardet e Cilësisë Shtetërore janë **përbushur kryesisht.**

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" është një universitet publik i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave në vitin 1994. Ka statutet e veta që janë konceptuar në një mënyrë që të reflektojnë misionin e Universitetit dhe përshtaten me kërkesat e ligjit shqiptar të arsimit të lartë. **[1.1]** Statutet dhe rregulloret zyrtare nxjerrë mbi këtë bazë, sigurojnë themelin për strukturën, organizimin dhe funksionimin e përditshëm të universitetit, si dhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të stafit dhe studentëve. **[1.2]** Me kalimin e kohës, statutet dhe rregulloret janë ndryshuar në përgjigje ndaj ndryshimeve në mjedisin e jashtëm dhe për të lehtësuar përmirësimet në funksionimin e universitetit. Përveç kësaj, secili fakultet dhe departament ka rregulloren e vet të brendshme. **[1.6]** Vitin e kaluar, Senati ngriti një grup pune për të hartuar statute dhe rregullore të reja pas miratimit të ligjit të arsimit të lartë nr. 80/2015. Zbatimi i ndryshimeve të propozuara është në vazhdim e sipër. Në fillim të këtij viti, u miratua nga Senati një strukturë e hollësishme organizative e rishikuar. **[AE18]** Rregullimet përfundimtare të organizimit dhe strukturës së universitetit janë në pritje të udhëzimeve të mëtejshme nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[Kapitulli III Standardi I.1]**

1.2 Statutet dhe rregulloret e universitetit përcaktojnë strukturën dhe organizimin e Universitetit, i cili përqendrohet në tre organe kryesore - Rektorati, Senati dhe Bordi i Administrimit. **[1,1; 1.2]** Rektorati përbëhet nga Rektori, dy Zëvendës Rektorët, Dekanët e Fakulteteve dhe Kancelari i universitetit, të gjitha përveç të fundit janë pozicione që zgjidhen. Rektorati është përgjegjës për buxhetin e universitetit dhe funksionimin e Universitetit në nivel institucional dhe nivel fakulteti. **[FE1.2; 1.3a; 1.3b]** Senati, i kryesuar nga Rektori, është autoriteti më i lartë akademik i universitetit dhe përfshin përfaqësuesit e zgjedhur të stafit dhe studentëve. **[M3]** Në mënyrë që të organizojë punën e vet në mënyrë të efektshme, Senati ka themeluar tre komisione të përqendruara gjerësisht në financën, kurrikulat dhe kërkimet. **[AE20]** Bordi i Administrimit, i ringritur këtë vit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 80/2015, përfshin anëtarët e universitetit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Bordi monitoron çështje financiare dhe administrative dhe punon me Senatin dhe Rektoratin për zhvillimin e buxheteve dhe planeve burimore. **[M4]** Organi i katërt qendror është Këshilli i Etikës i cili këshillon në lidhje me çështjet e etikës dhe standardeve të jetës akademike, si dhe heton shkelje të Kodit të Etikës të universitetit **[1.8; AE22]** Universiteti është në procesin e krijimit të një Bordi Këshillimor prej 15 personalitetesh të shquara kombëtare dhe ndërkombëtare, për të këshilluar Senatin lidhur me çështje të jashtme dhe strategjike. **[FE4.1; M1; M3]**

1.3 Provat dokumentuese me shkrim të paraqitura nga universiteti dhe diskutimet e zhvilluara me stafin dhe studentët tregojnë se janë në funksionim strukturat e menaxhimit, që veprojnë ashtu siç parashikohet në statut dhe rregullore të Universitetit. Universiteti është i strukturuar në katër fakultete të ndara në 17 departamente: këto njësi drejtohen nga dekanët e zgjedhur të fakultetit dhe përgjegjësitë e departamenteve. Fakultetet dhe departamentet kanë rregullat e tyre që rrjedhin nga statutet dhe rregulloret e Universitetit. **[1.6]** Sipas legjislacionit të mëparshëm, çdo fakultet kishte një Këshill Kolegjial të Fakultetit, i cili, ndër të tjera, mbikëqyrte planifikimin dhe shpërndarjen e burimeve të fakultetit dhe menaxhimin e shërbimeve të tij. Këto përgjegjësi po i kalojnë dekanëve dhe njërive administrative, që janë në pritje të udhëzimeve të mëtejshme nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[M2]** Sipas legjislacionit të mëparshëm, një Këshill i profesorëve vepronte në një

fakultet që kishte një program doktore. **[1.7]** Puna e këtij organi gjithashtu po riorganizohet sipas legjislacionit të ri.

1.4 Kohët e fundit janë mbajtur zgjedhjet për pozicionet me zgjedhje të dekanit dhe përgjegjësit të departamentit dhe për organet kyçe si Senati dhe Këshilli i Administrimit **[1.1; 1.2] [Kapitulli III Standardi I.2]**

1.5 Senati dhe Bordi i Administrimit mblidhen zyrtarisht në baza të rregullta. Ata funksionojnë sipas rregulloreve të universitetit, në të cilat përcaktohen roli, qëllimi dhe mënyra e funksionimit të tyre. **[1.2]** Dokumentet e Senatit u shpërndahen anëtarëve të tij disa ditë përpara. **[M3]** Komisionet e Senatit i filtrojnë çështjet dhe i paraqesin dokumentet përkatëse Senatit për të përshpejtuar vendimmarrjen. Bordi i Administrimit mblidhet dy herë në muaj me takime joformale dhe shkëmbime të pikëpamjeve në mënyrë elektronike ndërmjet mbledhjeve, për të siguruar vendimmarrje në kohë. Janë përdorur procese formale të mbajtjes së procesverbaleve dhe miratimit të vendimeve. **[M4]**

1.6 Universiteti ka sisteme të efektshme për të njoftuar stafin dhe studentët për çështjet që do të diskutohen në Senat dhe për të përcjellë vendimet në nivelet më të ulëta, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, zyra të dekanëve dhe departamenteve. Stafi dhe studentët që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, pohuan se këto mjete funksiononin në mënyrë efikase. **[M3; M5a; M5B; M8] [Kapitulli III Standardi I.3]**

1.7 Ligji për arsimin e lartë garanton autonominë e universitetit në lidhje me botën e jashtme. Në aspektin e brendshëm, autonomia e universitetit garantohet me statutet dhe rregulloret e tij. Universiteti është subjekt i auditimit të jashtëm dhe të brendshëm. Para riorganizimit që filloi si përgjigje në zbatim të ligjit nr. 80/2015, u krye një auditim formal nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[AE19]** Një njësi që titullohet Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit është themeluar në vitin 2013. Puna e saj përfshinte grumbullimin dhe analizën e të dhënave për Vlerësimin Institucional të vitit 2017. **[AE12]** Në institucionin e rishikuar janë ngritur edhe dy njësi të reja. **[AE18]** E para nga këto është Njësia e Auditimit të Brendshëm që i raporton Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Kjo njësi ndërthur ekspertizën ligjore dhe ekonomike dhe do të auditojë veprimtarinë akademike, ekonomike, financiare dhe administrative. Njësia e dytë është Njësia e Sigurimit dhe Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSVBC) që përbëhet nga tre anëtarë të stafit. Detyra e saj përfshin vlerësimin e cilësisë dhe standardeve të programeve studimore të universitetit dhe të kërkimit, si dhe cilësinë dhe menaxhimin e burimeve dhe shërbimeve në mbështetje të tyre. **[AE4]** Njësia ka filluar funksionimin dhe ka miratuar formularët për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe angazhimin e studentëve në zhvillimin institucional. **[M9]** Për të përfituar nga njohuritë dhe ekspertizën e jashtme, universiteti po merr pjesë në një projekt të përbashkët të Erasmus me një universitet në Republikën Çeke, për zhvillimin e sigurimit institucional të cilësisë **[1.35]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** hapat e ndërmarrë, për të vlerësuar dhe rishikuar dispozitat për sigurimin e cilësisë dhe standardeve nëpërmjet krijimit të NJSBVC-së. **[Kapitulli III Standardi I.4]**

1.8 Kohët e fundit është ngritur një strukturë e re: Zyra e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, për të shfrytëzuar në mënyrën më të mirë fondet e Bashkimit Evropian dhe fonde të tjera. **[1.16]** Roli i zyrës përfshin kërkimin e mundësive për mobilitetin e stafit dhe studentëve, dhe kërkimin shkencor; duke ndihmuar në bërjen e aplikimeve për projekte; dhe menaxhimin e projektit. **[M9] [Kapitulli III Standardi I.4]**

1.9 Strategjia e zhvillimit të universitetit u përgatit për të mbuluar vitet 2008-2013, dhe më pas u zgjat edhe në vitet 2013-2017. **[3.13]** Vendimmarrja aktualisht udhëhiqet nga një vizion i përbashkët dhe një dëshirë për t'u ndërkombëtarizuar, për të përmirësuar cilësinë dhe për të përmirësuar infrastrukturën. **[M3]** Që nga viti 2016, fakulteteve dhe departamenteve akademike u është kërkuar të shqyrtojnë dhe rishikojnë strategjitë e tyre, të miratuara më parë në vitin 2014, si pjesë e zhvillimit të një strategjie të re të nivelit institucional. **[AE7; 8; M3]** Universiteti ka hartuar dhe miratuar gjithashtu një Strategji të re të Burimeve Njerëzore për Kërkuesit dhe një Strategji të Ndërkombëtarizimit. **[01:19; 1.20]** Projektstrategjia në nivel institucional u përgatit nga një grup pune i udhëhequr nga Zëvendës-Rektori për Zhvillimin Institucional dhe Komunikimin. Ajo do t'i paraqitet Senatit në qershor të vitit 2017. Projektstrategjia pohon misionin e universitetit si një institucion rajonal i cili zbaton mësimdhënien dhe kërkimin, duke ofruar mundësi karriere për stafin dhe studentët dhe duke kontribuar në nevojat sociale, kulturore dhe zhvillimore të Shqipërisë. Dokumenti analizon zgjedhjet dhe alternativat që has universiteti dhe identifikon qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e duhura për të përmbushur misionin e vet. **[AE2]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë për përgatitjen dhe miratimin e një strategjie të re zhvillimi. **[Kapitulli III Standardi I.5]**

1.10 Universiteti publikon një raport vjetor për veprimtarinë akademike, kërkimore-shkencore dhe financiare. **[FE1.6]** Raporti i nivelit institucional përpilohet nga raportet e përgatitura në nivel fakulteti, ndërsa seksionet financiare përgatiten nga Këshilli i Administrimit, tani Bordi i Administrimit. Raporti diskutohet gjerësisht dhe miratohet nga Senati në një takim të hapur me pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit/Bordit të Administrimit, stafit dhe studentëve. Raporti përmban një analizë sasiore dhe cilësore të veprimtarisë së vitit të kaluar. Çështjet, qëllimet, objektivat dhe veprimet e propozuara janë identifikuar në raport për çdo fushë të veprimtarisë dhe përbëjnë plane veprimi për fakultetet dhe njësitë qendrore. Një kopje e raportit i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[Kapitulli III Standardi I.6]**

1.11 Liria akademike është e garantuar në statutet dhe rregulloret e Universitetit. **[1,1; 1.2]** Si një organ autonom, universiteti përcakton misionin e tij, kriteret e pranimit, ofrimin e programeve dhe organizimin brenda kuadrit të ligjit të arsimit të lartë. Liria akademike mbështetet nga delegimi i përgjegjësive në fakultete dhe departamente; emërimi i stafit të kualifikuar; dhe nxitja e bursave dhe kërkimeve të pavarura. Universiteti ndjek misionin e vet, duke nënshkruar marrëveshje me kategori të ndryshme partnerësh në Shqipëri dhe jashtë saj (shih pikën 1.17 më poshtë).

1.12 Universiteti ofron programe në të tre ciklet. Në ciklin e tretë ka vetëm një program, matematikën. Numri i programeve ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet ciklit të parë dhe të dytë, por studentët e ciklit të parë i tejkalojnë studentët e ciklit të dytë në raportin katër me një. Universiteti ka mbi 200 vetë staf akademik me kohë të plotë. Ka gjashtë profesorë dhe 27 profesorë të asociuar. Më shumë se gjysma e stafit akademik me kohë të plotë kanë diploma doktorature. **[Baza e të dhënave të APAAL-it]** Stafi akademik organizohet në katër fakultete, të cilat kanë së paku nga tre departamente dhe përmbushin kërkesat e deklaruara për numrin e nevojshme të stafit dhe kualifikimet. Universiteti ka një faqe interneti publike e cila përmban informacione për universitetin dhe aktivitetet e tij; disa faqe në lidhje me tema të tilla si shkëmbimet dhe konferencat janë në dispozicion edhe në gjuhën angleze. **[<http://univlora.edu.al>] [Kapitulli III Standardi II.1]**

1.13 Bordet zyrtare, Senati, Bordi i Administrimit dhe Këshilli i Etikës veprojnë në nivel institucional. Këshillat e Fakultetit dhe Profesorëve, të cilët vepronin më parë në nivel

fakulteti, nuk funksionojnë aktualisht dhe janë në proces të zëvendësimit me procese dhe organe të reja pas miratimit të ligjit nr. 80/2015 dhe hartimit të rregulloreve të reja të fakultetit dhe departamenteve.

1.14 Studentët mund të ngrenë çështje, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre dhe të presin që Këshilli i Studentëve të jetë një mjet i rëndësishëm për ngritjen e çështjeve, kur ai të jetë plotësisht funksional. Studentët tregojnë se pikëpamjet e tyre dëgjohen dhe u jepet përgjigje, dhe dhanë shembuj që përfshinin një përgjigje pozitive të universitetit për kërkesën për më shumë praktikë në infermieri, dhënien e orëve mësimore shtesë para provimeve dhe një ndryshim në vlerësimin e studentëve të ciklit të parë. **[M2; M5a; M5b]** Stafi mund të ngrejë çështje në nivelin e departamentit, të cilat pastaj mund të përshkallëzohen në nivelin e fakultetit dhe në Rektorat dhe Senat. Vendimet e Senatit dhe Bordit të Administrimit publikohen me anë të mediave elektronike ose në letër; dhe përcillen në nivelet poshtë, në departamentet dhe organet e studentëve. **[M3; M4]** Janë mbajtur takime të hapura për të diskutuar rreth dokumenteve me rëndësi për mbarë universitetin, siç është raporti vjetor dhe dokumenti i vetëvlerësimit i përgatitur për këtë vlerësim. **[M2] [Kapitulli III Standardi II.3]**

1.15 Universiteti ndodhet në një qytet të vogël që vepron si qendër tregtare dhe qendër bashkiake e rajonit të saj. Ajo karakterizohet nga rrjete të fuqishme vendore që përfshijnë universitetin. Këto rrjete japin akses në informacion rreth ekonomisë vendore dhe kërkesës për të diplomuarit. **[FE1.28; M6a; M6b]** Të diplomuarit e Universitetit të Vlorës kryesojnë punësimin në shumë organizata vendore, si zyra e taksave, bankat, shkollat dhe stafi infermior në spitalet vendore. Shumica e drejtuesve të bizneseve vendore janë të diplomuarit e universitetit. Universiteti mban kontakt me punëdhënësit nëpërmjet Qendrës së Këshillimit të Studentëve në lidhje me mundësitë për praktikë profesionale, punë dhe informacion mbi të diplomuarit e punësuar në organizatat e tyre. **[AE18 f.13-14]** Qendra është gjithashtu përgjegjëse për mbështetjen dhe organizimin e Shoqatës Alumni që është në një fazë të hershme zhvillimi. Qendra punon me një rrjet koordinatorësh të bazuar në fakultete dhe departamente. **[M2]** Drejtoria e TI-së dhe Statistikave ka për detyrë të “zhvillojë dhe menaxhojë regjistrin elektronik të të diplomuarve të UV sipas të dhënave zyrtare të fakulteteve”. **[AE18 f.16]** Është krijuar një tabelë në bazë e të dhënave për një mijë të diplomuar në 15 vitet e fundit, të punësuar në organizatat vendore. **[FE1.9]** Megjithatë, të diplomuarit pohuan se ndërsa punësimi vendor i të diplomuarve është i rëndësishëm, shumë nga bashkëmoshatarët e tyre janë larguar në një zonë në vend ose jashtë shtetit. **[M6a]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon punën në proces e sipër, për të monitoruar sistematikisht punësimin e të diplomuarve të tij. **[Kapitulli III Standardi III.1]**

1.16 Universiteti respekton rregullat e konkurrencës për stafin, studentët dhe burimet. Kriteret transparente dhe meritokratike përdoren në rekrutimin dhe përzgjedhjen e stafit dhe studentëve. Informacioni për programin dhe tarifat e shkollimit publikohen në faqen e internetit të universitetit së bashku me informacione të tjera rreth universitetit, duke përfshirë misionin, vlerat dhe organizimin e tij. **[Kapitulli III Standardi III.1]**

1.17 Universiteti identifikon zhvillimin e partneriteteve të reja në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar ndër prioritetet e veta strategjike. **[AE2]** Bashkëpunimi dhe partneriteti janë thelbësore për qëllimet e Universitetit për ndërkombëtarizimin, nxitjen e veprimtarisë kërkimor dhe sigurimin e arsimit të cilësisë së lartë. Strategjitë e fakulteteve dhe e departamenteve gjithashtu theksojnë rëndësinë e bashkëpunimit. Universiteti ka nënshkruar disa marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe jashtë vendit, për të lehtësuar shkëmbimin e stafit dhe studentëve dhe për të ndërmarrë kërkime të përbashkëta.

[1.32.1; 1.32; 1.33] Funkcionojnë edhe partneritetet me organizatat joarsimore që mbështesin mësimdhënien dhe kërkimin në mënyra të ndryshme. Bashkëpunimi nxitet edhe nëpërmjet mbajtjes së konferencave akademike, për shembull me Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë në Kosovë. [[Http://conferences.ubt-uni.net/2016](http://conferences.ubt-uni.net/2016)]

1.18 Është themeluar kohët e fundit një Zyrë e re e Projekteve dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare nën drejtimin e Zëvendës-Rektorit për Zhvillimin Institucional dhe Komunikimet. Detyra e kësaj zyre përfshin promovimin e partneriteteve dhe krijimin e marrëdhënieve bashkëpunuese. [AE2] [Kapitulli III Standardi III.2]

1.19 Shumë nga programet e ofruara nga Universiteti janë të një natyre të zbatuar dhe të gjitha kualifikimet e ciklit të dytë përfshijnë stazhin e punës. Universiteti ka marrëveshje me spitalet vendore, për të ofruar vende për zhvillimin e praktikës për studentët e infermierisë. [1.32; 1.36; FE1.8] Ekziston një lidhje e ngushtë midis Universitetit dhe Këshillit Vendor të Arsimit, për të lehtësuar studentët që të zhvillojnë praktikën e mësimdhënies dhe të përmbushin kërkesat për marrjen e licencës së profesionit të tyre. [M6b] Mundësitë e praktikës profesionale ofrohen nga organizatat publike dhe private që janë me përfitim për të dyja palët. Këto mundësi shpesh ndihmohen nga alumni. [M6a] Studentët gjithashtu mund të marrin pjesë në nisma të përbashkëta kërkimore siç janë ato të sponsorizuara nga Qendra për Zhvillim Rajonal. [M6b] Programet në të gjitha nivelet përfitojnë nga lektorët e ftuar, aksesit i stafit në praktikën aktuale, dhe *feedback* nga punëdhënësit për kurrikulat dhe performancën e studentëve. [Kapitulli III Standardi III.3]

1.20 Angazhimi i Universitetit për nxitjen e mobilitetit pasqyrohet në statutet e tij, ku shprehet se “e konsideron shkëmbimin, mobilitetin e studentëve dhe të stafit si një nga detyrat kryesore”. [1.1] Mobiliteti është gjithashtu në qendër të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit dhe projektstrategjisë institucionale. [AE2] Universiteti ka aktualisht partneritete dhe marrëveshje që lehtësojnë mobilitetin nëpërmjet programeve të tilla si Erasmus. Studentët janë të vetëdijshëm për mundësitë. [M5b] Megjithatë, vizitat dhe shkëmbimet e stafit dhe shkëmbimet e studentëve janë në nivele modeste, pjesërisht për shkak të gjuhës. Universiteti nuk ka studentë të huaj të regjistruar edhe pse ka kuota për studentët shqiptarë nga Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia. [FE3.1]

1.21 Zyra e sapokrijuar e Projekteve dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të universitetit është përgjegjëse për mbështetjen e mobilitetit dhe mbështetjen e stafit dhe studentëve, që vijnë në universitet ose ata që shkojnë jashtë shtetit. Dokumentet kryesore dhe informacionet për studentët e huaj janë në dispozicion në gjuhën angleze në faqen e internetit të Universitetit. [[Http://univlora.edu.al/en](http://univlora.edu.al/en)]

1.22 Universiteti e nxit veprimtarinë ndërkombëtare në kërkim dhe bursa, nëpërmjet projekteve dhe konferencave të përbashkëta. Është krijuar një rrjet global i kërkuesve shqiptarë për të ndihmuar në zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe për të mbështetur mobilitetin. [<http://univlora.edu.al/en/arkiva/8221>][Kapitulli III Standardi III.4]

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e mëposhtme që po ndërmerren:

- ngritja e Njesisë së Sigurimit dhe Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë (pika 1.7; **Kapitulli III Standardi I.4**)
- procesi i ndërmarrë për të zhvilluar dhe miratuar një strategji të re zhvillimi (pika 1.9; **Kapitulli III Standardi I.5**)
- puna që po bëhet për të monitoruar në mënyrë sistematike punësimin e të diplomuarve të vet. (pikat 1.15 dhe 5.16; **Kapitulli III Standardi III.1**).

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Universiteti ndjek një politikë të hapur në lidhje me rekrutimin dhe punësimin e burimeve njerëzore. Statutet e Universitetit (nenet 38-52) **[1.1]** dhe rregulloret (nenet 26-34) **[1.2]** përcaktojnë parimet dhe kuadrin për burimet njerëzore, të cilat janë të detajuara në Strategjinë e Burimeve Njerëzore **[1.19]** dhe Procedurën e Rekrutimit të Stafit Akademik. **[2.2]** Janë vënë në dispozicion evidenca për këto procedura që janë kryer në praktikë, nëpërmjet dokumenteve që përcaktojnë pikët e vlerësimit të aplikantëve, vendimin, verifikimin, ngarkesën mësimore dhe shkresat e ofertës. **[2.4B; 2.6; 3.19-3.22]** Universiteti ka një proces planifikimi që identifikon nevojat vjetore të stafit të vet dhe raportin e stafit me kohë të pjesshme **[2.1; 2.2]** Universiteti i jep përparësi rekrutimit të akademikëve nga universitetet e njohura ndërkombëtare, nëpërmjet shpërndarjes së pikave shtesë në matricën e rezultateve të kandidatit. **[2.5]** Universiteti është nënshkruar i Kartës Evropiane për Kërkuesit dhe Kodit të Sjelljes për Rekrutimin e Kërkuesve **[2.2]** dhe ka marrëveshje me Universitetin e Tiranës për promovimin e stafit në profesor në fushat në të cilat ai nuk ka programe të ciklit të tretë. **[RVV fq.19]** Universiteti shpall vendet e lira në faqen e vet dhe atë të Zyrës së Prokurimit Publik dhe publikon strukturën e tij organizative në faqen e tij të internetit **[Ev verifikuar 15/4/17, <http://univlor.edu.al/organigrama>] [Kapitulli III Standardi IV.1]**

2.2 Universiteti nuk ka një procedurë zyrtare të instruktimit. Sidoqoftë, pritet dhe përbën praktikë të përbashkët që stafi i ri do të monitorohet dhe ndihmohet nga një profesor i vjetër brenda fushës së disiplinës, ose nga drejtuesi i tyre i linjës për stafin administrativ **[M2; M8]** Rrjedhimisht, instruktimi është joformal dhe sipas rastit. Gjithashtu, nuk ka instruktim apo trajnim formal në pedagogji për stafin. Ka evidenca për programet e “trajnimin të trajnerëve” dhe kurseve të tjera që kanë ndjekur stafi, por ato duket se janë trajnime teknike dhe përditësimi (një shembull është nga Navigacioni) **[2.8]** dhe jo instruktim i përgjithshëm ose trajnim pedagogjik. Është raportuar se pjesëtarët e stafit janë pothuajse të gjithë ish-studentë të universitetit dhe kanë mbajtur pozicione me kohë të pjesshme dhe kështu që zvogëlohet nevoja për instruktim. Ka evidenca të përfshirjes së stafit në ditët e hapura dhe aktivitete të tjera dhe shpërndarjes së materialeve informuese. **[2.7; 3.2; 3.3; 3.4]** Universiteti dëshiron të marrë në konsideratë futjen e një programi formal të instruktimit, për të siguruar që stafi të prezantohet vazhdimisht dhe sistematikisht me rolin e tyre dhe me pritshmëritë dhe kërkesat e mësimdhënies dhe administrimit brenda universitetit **[Kapitulli III Standard IV.2]**

2.3 Universiteti ndjek një politikë të vlerësimit periodik të aftësive të stafit të tij. Universiteti përcakton në Statutet e tij **[1.1]** dhe Rregulloret Universitare **[1.2]** parimet dhe përgjegjësitë për vlerësimin e performancës së stafit. Përgjegjësi i departamentit ngarkohet me detyrën e vlerësimit të stafit **[1.2 Neni 23]** ndërsa koordinimi i funksionit të vlerësimit dhe shpërndarja dhe bashkërendimi i pyetësorëve dhe formularëve të tjera të mbledhjes së informacionit janë përgjegjësi e Njesisë e Sigurimit dhe Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë të krijuar së fundmi. **[1.1 Neni 52, AE4]** Rregulloret parashikojnë që kjo njësi synon të shqyrtojë periodikisht efikasitetin e veprimtarive didaktike dhe praktikës profesionale, procesin e vlerësimit të përvetësimit të njohurive, diplomimit dhe veprimtarive të tjera administrative dhe financiare të ndërmarra nga universiteti çdo semestër, dhe i dorëzon një raport vlerësimi Rektorit **[1.2 Neni 86]** Stafi pohon se mbledhjet e vlerësimit bëhen çdo vit nga përgjegjësi i departamentit, si pjesë e vlerësimit vjetor të punës së departamentit dhe merr në

konsideratë një sërë informacionesh, përfshirë pyetësorët e studentëve për *feedback*. **[M8]** Studentët pohuan se atyre u kërkohet të plotësojnë pyetësorët mbi performancën e pedagogëve të tyre në baza afatgjatë dhe të japin shembuj se si çështjet që kanë ngritur u trajtuan nga universiteti. **[M5a]** Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu raportua që informacioni mbi vlerësimin e stafit integrohet në raportet vjetore të departamenteve (shih pikën 4.7 më poshtë).

2.4 Universiteti nxit pjesëmarrjen e stafit të tij në universitetet perëndimore, nëpërmjet mobilitetit dhe marrëveshjeve bashkëpunuese **[1.33; 1.34]** dhe njeh arritjen e stafit të vet nëpërmjet shkallës së promovimit dhe disa kontributeve financiare për pjesëmarrjen në konferenca dhe botimin e artikujve. **[RVV f.20; 2.8; 2.9; 2.10]** Universiteti nuk siguron që profesorë të huaj të jenë të pranishëm në komisionet e tij të promovimit dhe nuk zbaton kriterin e një viti eksperience në një universitet Perëndimor për promovim në profesor (Standardet Shtetërore 1V.3 kriteret 3 dhe 4) sepse nuk i është njohur e drejta për të ofruar promovim në profesor. **[RVV f.20; Ref VKM nr. 467, 18.07.2007] [Kapitulli III Standardi IV.3]**

2.5 Universiteti ndjek një politikë të zhvillimit social, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve sociale, kulturore dhe edukative, si diskutimet tematike mbi diversitetin dhe autizmin. Studentët e Universitetit ndërmarrin vizita në komunitet duke mbështetur bamirësinë dhe duke ndihmuar, për shembull, në jetimoret. **[RVV f.20; M5a; GID]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u vu në dijeni gjithashtu për marrëdhëniet shumë të ngushta dhe reciprokisht të dobishme ndërmjet Universitetit dhe partnerëve të jashtëm dhe palëve të interesit, në të mirë të komunitetit. **[M6]** Universiteti mbulon sigurimet e jetës dhe ato shëndetësore për stafin, që administrohen nga Zyra e Financave. **[Kapitulli III Standardi IV.4]**

2.6 Universiteti siguron menaxhimin e efektshëm të funksioneve të burimeve njerëzore nëpërmjet përcaktimit të rregullave dhe përgjegjësive në statutin e tij dhe në rregulloret administrative, **[1.1; 1.2]** mbështetur nga procedura të detajuara në Strategjinë e Burimeve Njerëzore **[1.19]** dhe Procedurën e Rekrutimit të Stafit Akademik **[2.2]** dhe mbikëqyren nga Zyra e Burimeve Njerëzore. **[1.2 Neni 13]** Të drejtat dhe detyrimet kontraktuale për secilin punonjës përcaktohen në kushtet e tyre të punësimit dhe përshkrimit të punës dhe depozitohen në Zyrën e Burimeve Njerëzore. **[2.2]** Dokumentet mbështetëse japin qartësi të mtejshme në përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive dhe kritereve për promovim. **[1.6; 2.1; 2.2; 2.3; 2.4; 2.6] [Kapitulli III Standard II.2]**

2.7 Në përputhje me kërkesat ligjore, Universiteti përdor një model buxheti afatmesëm që shtrihet për një periudhë trevjeçare dhe që shqyrtohet dhe ndryshohet mbi baza vjetore. Struktura për përcaktimin, hartimin dhe vlerësimin e buxhetit është në përputhje me dispozitat statutores. **[1.1 Nenet 56-59, 2.10; 2.10 Buxheti]** Buxheti ndjek një qasje nga poshtë lart, me kërkesat e departamenteve dhe njësisive administrative që kalojnë nëpërmjet fakulteteve, për t'u përcjellë pranë Drejtorisë së Financave dhe Ekzekutimit të Buxhetit në Rektorat. Buxheti shqyrtohet nga Senati Akademik përpara se të kalojë në Këshillin e Administrimit (tani Bordi i Administrimit) për miratim. **[2.11]** Sapo miratohet, buxheti i detajuar kalohet përsëri në nivel fakulteti dhe departamenti për zbatim. **[M3; M4] [Kapitulli III Standard VI.1]**

2.8 Universiteti ka struktura dhe ekspertizë të përshtatshme organizative për zbatimin e politikës së tij financiare dhe buxhetore. Përgjegjësia kryesore për zbatimin e buxhetit i përket Drejtorisë së Financave dhe Ekzekutimit të Buxhetit, që përfshin gjashtë punonjës dhe që është nën përgjegjësinë e administratorit. Termat e referencës dhe përgjegjësitë e tij, përfshirë zbatimin e rregullave të kontabilitetit, janë përcaktuar në strukturën e re organizative. **[1.16]** Përgjegjësia ekzekutive për analizë dhe zbatim përcaktohet në rolet dhe përgjegjësitë e Statutit të Universitetit **[1.1 Nenet 12, 16, 17, 19]** Ekzekutimi faktik i përgatitjes dhe zbatimit të buxhetit shqyrtohet nga Komiteti i Buxhetit dhe Ligjeve, një nënkomision i Senatit Akademik i themeluar për këtë qëllim, të cilit i dorëzohet raporti vjetor i auditimit. **[FE19, 21] [Kapitulli III Standard VI.2]**

2.9 Përveç përgjegjësisë operative që i takon Drejtorisë së Financave dhe Ekzekutimit të Buxhetit, universiteti kontrollon buxhetin nëpërmjet Njesisë së Auditimit të Brendshëm **[1.16]** dhe rolit të Drejtorit të Financave. **[1.1 Neni 19]** Drejtori i Financave analizon treguesit ekonomikë dhe financiarë për të mbështetur buxhetin **[2.12]** Universiteti deri më tani nuk ka kryer auditimet e veta të brendshme, por sipas ligjeve të reja në fuqi ka themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm **[1.16; FE19]** Universiteti i është nënshtruar auditimit nga ana e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[FE19]** Universiteti e përcjell raportin e auditimit të jashtëm në nivelet më poshtë, në komitetet e tij dhe e publikon në faqen e tij të internetit **[M4]** dhe organizon një takim të hapur vjetor në të cilën diskutohet veprimtaria e universitetit. **[M8] [Kapitulli III Standard VI.3]**

2.10 Universiteti ka pasur përvojë në tre sisteme të menaxhimit të informacionit: SIUV nga 2008-2011, SMI-Univlora nga 2011-2016 dhe ESSE3 në 2016, i cili mbështetet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[1.11; 2.14]** ESSE3 ofron informacion për stafin dhe studentët në lidhje me regjistrimin, informacionin bazë të programit, oraret e mësimdhënies dhe vlerësimit, rezultatet dhe diplomimin. **[RVV fq.22]** Përmes ESSE3 Universiteti ka një marrëdhënie me Agjencinë Kombëtare të Provimeve dhe mund të nxjerrë të dhënat e aplikantit. Të dhënat e universitetit përcillen me anë të ESSE3 në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Universiteti publikon të dhëna për numrin e studentëve për çdo program dhe të dhëna dhe informacione të tjera kryesore në faqen e vet, së bashku me politikën e lirisë së informacionit. **[2.15] [Kapitulli III Standard VII.1]**

2.11 Sistemi ESSE3 mbështetet nga Departamenti i Informacionit dhe Teknologjisë. **[1.1 neni 10]** I gjithë stafi pohoi se ka akses në sistem. Ka tri laboratorë kompjuterikë për studentët (1 në Ndërtesën A dhe 2 në Ndërtesën C) me një total prej 166 kompjuterësh. **[RVV f.2, GIP]** Nga kjo rrjedh që raporti kompjuter/student është më shumë se 1:50. Studentët dhe kërkuesit u shprehën se nuk kanë akses të mjaftueshëm në kompjuterë dhe universiteti ka pranuar se nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesën dhe se në disa ambiente të universitetit ka probleme me lidhjen në internet. Megjithatë, buxheti vjetor ka planifikuar trajtimin e këtyre çështjeve. Është vënë re se shumica e stafit sjellin laptopët e tyre. **[M9] [Kapitulli III Standardi VII.2]**

2.12 Universiteti ka një plan gjithëpërfshirës dhe të koordinuar për menaxhimin e pronave të veta. Kur u themelua universiteti në vitin 1994, trashëgoi disa ndërtesa të vjetra që kishin nevojë për rinovim dhe restaurim. Gjatë shtatë viteve të fundit, universiteti ka ndërmarrë një program të ri të rëndësishëm ndërtimi dhe rindërtimi. Në vitin 2010 u ndërtua Fakulteti i Shkencave Teknike. Ndërtesa A u rikonstruktua në vitin 2014 së bashku me Sallën e

Mbledhjeve dhe Ndërtesën e Rektoratit, kur filloi edhe rindërtimi i Ndërtesës B. **[RVV f.22-23; 2.16; 2.17; 2.18; 2.19]** Universiteti ka një Zyrë Qendrore të Mirëmbajtjes e cila është përgjegjëse për regjistrimin e aseteve fikse dhe mirëmbajtjen dhe zhvillimin e tyre. Raporti i Vetëvlerësimit nxjerr në pah kapacitetin e ndërtesave, të cilat mbështeten më hollësisht nga planet e bashkangjitura në dokumentet e mësipërme. **[Kapitulli III Standardi VII.3]**

2.13 Universiteti ka struktura dhe procese të përshtatshme për mbajtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e stokut të librave dhe materialeve online. Është duke u zhvilluar projekti i katalogimit të stokut aktual, i cili përdor standardet dhe sistemet e COBISS.Net (Sistem Bibliografik dhe Shërbime Bibliografike Online) për qëllime bibliografike dhe aksesueshmërie. Një projekt për krijimin e një arkivi dixhital të materialeve të Universitetit është planifikuar të fillojë në vitin 2017. Universiteti e nxit stafin që të ndihmojë në zhvillimin e burimeve të Pronësisë Intelektuale të universitetit, nëpërmjet botimeve në Revistën Universitare dhe duke i dhuruar bibliotekës kopje të punëve të tjera të botuara dhe materialeve të tyre. **[RVV f.23; M9; 4.14; 4.43] [Kapitulli III Standardi VII.4]**

2.14 Universiteti ka tashmë politika dhe mekanizma për të menaxhuar, ruajtur dhe përmirësuar asetet e veta. **[1.1; 1.2; 1.16; 1.21]** Në një nivel praktik këto janë të nxitura nga plani gjithëpërfshirës dhe afatgjatë për të rindërtuar dhe rinovuar ndërtesat e tij. Fokusi në aktivet e përditshme është më pak i sofistikuar dhe i koordinuar dhe më i posaçëm, me kërkesa që vijnë nga departamentet dhe fakultetet si nevoja, dhe që rrjedhimisht çojnë në standarde të ndryshueshme për sa i përket shërbimeve të të gjithë departamenteve. **[2.10; M5a; M5B; M8; M9] [Kapitulli III Standard VII.5]**

2.15 Nuk ka një Zyrë Qendrore Universitare që koordinon, mbështet dhe vlerëson aktivitetet e grupit të tretë (aktivitete përveç mësimdhënies dhe kërkimit akademik, si transferimi i njohurive, angazhimi i komunitetit dhe zhvillimi i biznesit). Megjithatë, raportet e vetëvlerësimit paraqesin shembuj të aktiviteteve nga departamente, në veçanti, që janë të lavdërueshme në vetvete dhe të cilat gjenerojnë të ardhura prej 5 milionë lekësh **[2.20; 2.21]** Raporti pohon se këto shërbime nuk janë vlerësuar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u vu në dijeni nga partnerët dhe aktorët e jashtëm për vlerën e kontributit që universiteti u jep atyre dhe rajonit më gjerë. Këto aktivitete përfshijnë përfitimet, duke ofruar të diplomuar të gatshëm për të bërë karrierë në biznes dhe tregti, nëpërmjet praktikave dhe punësimit, kërkimit dhe shkëmbimit të njohurive dhe mbështetjes së ekspertëve. **[M6] [Kapitulli III Standard VII.6]**

2.16 Universiteti e ka pranuar se ambientet dhe infrastruktura e tij nuk i plotësojnë ende standardet e kërkuara ose aspiratat e veta. Ai ka deklaruar në dokumentet e vetëvlerësimit dhe ma anë të përfaqësuesve në takime që po punon për të përmirësuar “burimet njerëzore, infrastrukturore, materiale dhe financiare” të burimeve të veta. **[RVV f.51]** Zbatimi i planeve afatgjata të zhvillimit të universitetit ka bërë përmirësime gjatë shtatë viteve të fundit, por ende ka mangësi. Universiteti aktualisht ka një hapësirë të përgjithshme prej 11,190 metra katrorë. Sidoqoftë, me afërsisht 9,000 studentë raporti i hapësirës për student qëndron në 1: 1.27 metra katror dhe Standardi Shtetëror **(Kapitulli III Standardi V.1)** nuk është përmbushur. **[GIP; RVV fq.23; M2; M4; M8]** Universiteti gjithashtu pranon se, në disa nga ndërtesat e tij të paktën, ka problematika në lidhje me disponueshmërinë e burimeve që kanë të bëjnë me ajër të kondicionuar, sisteme bashkëkohore të parandalimit të zjarrit, auditore, hapësira të mjaftueshme në klasat e seminarit dhe bibliotekat, dhe akses dhe rrugë dalje të

mjaftueshme dhe të sigurta, si dhe akses në PC (duke qenë se raporti është mbi 1:50 studentë). [RVV; GID; V; Vizita M2; M5a; M5b; M8; M9] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mospërbushjen e standardeve në lidhje me hapësirën dhe pamjaftueshmërinë e disa prej ndërtesave dhe objekteve, si një dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vë në dukje programin e ndërtimit dhe rinovimit që vazhdon të ndërmerret nga Universiteti, për të përmirësuar infrastrukturën e tij, por nuk mendon se kjo do të jetë e mjaftueshme. Rrjedhimisht, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Universiteti të ndërmarrë hapa për të siguruar që burimet e tij fizike të jenë në përputhje me standardet shtetërore të kërkuara (**Kapitulli III Standardi V.1** dhe veçanërisht kriteri 5) dhe të sigurojnë cilësinë e mundësive të të mësuarit. [**Kapitulli III Standardi V.1**]

2.17 Universiteti ka njësi të specializuara për mbajtjen e të dhënave të tij në formë të shtypur dhe elektronike. Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit është përgjegjës për ruajtjen e dokumentacionit në kopje fizike, ndërsa Zyra e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave është përgjegjëse për digjitalizimin e të dhënave dhe krahasimin e statistikave. Sekretarët e fakultetit mbajnë të dhëna për regjistrimin, arritjet dhe diplomimin e secilit student, të mbështetur nga ESSE3. [RVV f.25; 1.11; 1.16; 2.22] [**Kapitulli III Standardi V.2**]

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- pamundësinë për të përmbushur standardet në lidhje me hapësirën fizike dhe gjendjen e ndryshueshme të ndërtesave dhe ambienteve (pika 2.16, **Kapitulli III Standardi V.1**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Universiteti të ndërmarrë hapa për të siguruar që burimet e tij fizike të jenë në përputhje me standardet e kërkuara shtetërore (**Kapitulli II, Standardi V.1** dhe veçanërisht kriteri 5) dhe të sigurojnë cilësinë e mundësive për të mësuarit (pika 2.16; **Kapitulli III Standardi V.1**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur pjesërisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Roli dhe misioni i universitetit është të ofrojë “mësimdhënie bashkëkohore në përputhje me standardet ndërkombëtare; kërkim bazë dhe të aplikuar të cilësisë së lartë dhe punë akademike; shërbim të efektshëm dhe të konsiderueshëm për publikun dhe komunitetin; programe gjithëpërfshirëse të zhvillimit të studentëve.” [1.1] Në përputhje me këtë mision, ka katër fakultete, që, mes tyre, ofrojnë programe në të tre ciklet e Bolonjës. Programet e ciklit të tretë (doktoratë) kufizohen në Matematikë, në Fakultetin e Shkencave Teknike. [3.1] Universiteti ofron informacion në lidhje me programet e tij të studimit, nëpërmjet faqes së tij të internetit dhe ditëve të hapura. [3.2; 3.3] Universiteti ka krijuar një profil institucional në fushën e turizmit, lundrimit, ekonomisë dhe infermierisë, dhe disa prej këtyre specialiteteve lidhen me vendndodhjen e tij gjeografike. [RVV fq.27; 3.4] Universiteti zbaton procedura të qarta aplikimi dhe kriteret pranimi për studentët shqiptarë. [3.5; 3.5.1; 3.5.2] Universiteti ofron kuota për shqiptarët nga Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia edhe pse asnjë student nuk është regjistruar nga këto rajone që nga viti akademik 2013-2014. [FE3.1] Statuti dhe rregulloret përcaktojnë qartë rregullat për vlerësim. [3.1; 3.2] [Kapitulli I Standardi I.1]

3.2 Deri kohët e fundit, universiteti ofronte programe me kohë të pjesshme në ciklin e parë dhe ciklin e dytë në fushën e ekonomisë dhe të drejtësisë. [3.12] Megjithatë, ndryshimet në ligj në vitin 2014 nuk i lejuan programet me kohë të pjesshme, të cilat janë mbyllur për aplikantët e rinj. Universiteti krijoi një Zyrë për të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës në vitin 2010, por puna e saj deri më tani është përqendruar në organizimin e konferencave, menaxhimin e projekteve dhe nxitjen e stafit dhe mobilitetit të studentëve. [AE5] Qendra e Trajnimit Detar, e hapur në dhjetor të vitit 2016, do të veprojë si një qendër e të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke trajnuar studentët për programet detare si lundruer, si dhe anëtar ekuipazhi anijesh. [3.11] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon punën që po ndërmerr Universiteti për të forcuar shërbimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës [Kapitulli I Standardi I.2]

3.3 Universiteti ofron programe studimi në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit 2008-2013, Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2016-2020 dhe strategjitë e fakulteteve. [3.13; 1.20; 3.14] Ai publikon informacion në lidhje me programet e tij të studimit në faqen e vet të internetit. [3.15] Përpos kësaj, stafi akademik viziton shkollat e mesme për të këshilluar studentët e ardhshëm mbi mundësitë që u ofrojnë atyre, dhe aplikantët potencialë kanë mundësinë ta vizitojnë Universitetin. [M5a] [Kapitulli I Standardi I.3]

3.4 Fokusi i Universitetit në ofrimin e programeve që pasqyrojnë prirjet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare është në përputhje me Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit. [RVV f.30] Kurset e gjuhëve të huaja janë të disponueshme për të gjithë studentët e ciklit të parë, brenda vetë programit ose në kuadrin e projekteve ndërkombëtare [3.6.1-3.6.9; 3.16 - 3.18] Janë bërë përpjekje për të ofruar programe më diploma të përbashkëta dhe për të bashkëpunuar me universitete të tjera në kurse ose module të përbashkëta, por deri më tani nuk kanë qenë të suksesshme [RVV f.30] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pa një shembull të një projekti Tempus në të cilën Universiteti kishte marrë pjesë, dëshmi e një projekti me titull “Modernizimi dhe harmonizimi i arsimit detar në Mal të Zi dhe Shqipëri”. [3.25] Ndërkombëtarizimi është identifikuar si një nga prioritetet kryesore të Universitetit. [M2; M4] [Kapitulli I Standardi I.4]

3.5 Ngarkesa mësimore e pedagogëve caktohet çdo vit në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj. **[3.19]** Çdo orë mësimi shtesë i zhvilluar nga stafi akademik, përtej shpërndarjes së ngarkesës akademike, paguhet nga universiteti **[3.20]** Modeli i ngarkesës akademike të stafit akademik pasqyron ekulibrin midis mësimdhënies, kërkimit dhe administrimit. **[FE3.2; AE22]** Funkionimi i modelit sigurohet nëpërmjet një marrëveshjeje të nënshkruar nga anëtari i stafit dhe Përgjegjësi i Departamentit, i cili shqyrtohet në fund të vitit akademik. **[M1] [Kapitulli I Standardi I.5]**

3.6 Informacioni për të gjitha programet e studimit është në dispozicion në faqen e internetit të Universitetit (www.univlora.edu.al). Përveç kësaj, stafi akademik përcaktojnë syllabusin dhe kërkesat e vlerësimit për studentët në fillim të programit të tyre. **[RVV fq.30-31; M5a]** Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e të nxënësve përcaktohen dhe miratohen nga departamenti, fakulteti dhe Senati, në përputhje me rregulloret e universitetit, dhe, studentët të cilët takoi Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pohuan se ata ishin të qarta në këtë aspekt. **[3.23.1-3.23.5; M5a]** Kriteret specifike të pranimit të programit miratohen çdo vit nga Senati **[3.5, 3.5.1] [Kapitulli I Standard I.6]**

3.7 Programet e studimeve të ciklit të parë u ofrojnë studentëve njohuri dhe aftësi për të lehtësuar përparimin në ciklin e dytë. **[3.7]** Kriteret për pranimin në programet e ciklit të dytë dhe të tretë janë të përcaktuara qartë. **[3.24]** Në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve, programet e ciklit të parë kanë parashikuar 180 kredite dhe sigurojnë akses në programet e nivelit Master në Shqipëri dhe jashtë saj **[3.6.1 - 3.6.4]** Informacioni për transferimin e krediteve publikohet në faqen e internetit të universitetit **[www.univlora.edu.al/statuti]** dhe studentët gjithashtu mund të marrin këshilla dhe udhëzime nga Sekretaria e Departamentit. **[RVV f.31]** Studentët që nuk i vazhdojnë studimet e ciklit të dytë dhe të tretë mund të hyjnë në tregun e punës dhe natyra e zbatuar e programeve të ciklit të parë si ato në Navigacionin dhe Inxhinierinë Detare e lehtëson këtë. **[RVV; 3.25] [Kapitulli I Standardi I.7]**

3.8 Universiteti ka një Qendër Këshillimi Studentor roli i të cilës përfshin monitorimin dhe mbështetjen e ecurisë së studentëve. **[RVV fq.32; 1.16]** Një sistem menaxhimi i të dhënave të studentëve përdoret për të ndihmuar me këtë. Përveç kësaj, studentëve u jepen udhëzime nga stafi akademik. **[M5a]** Stafi akademik rekrutohet në përputhje me Vendimin e Senatit Akademik "Për procedurat e punësimit dhe përzgjedhjes për stafin akademik". Stafi akademik me kohë të plotë përbëjnë rreth 82 për qind të atyre që japin mësim në programet e ciklit të parë, duke tejkaluar kërkesat minimale të qeverisë **[70] [3.26]** Universiteti përcakton qartë kriteret e tij për rekrutimin e stafit të ri akademik me kohë të plotë, të cilat i japin përparësi atyre me doktoraturë dhe atyre që janë kërkues aktivë. **[RVV fq.32; AE6] [Kapitulli I Standard I.8; Kapitulli I Standardi I.9]**

3.9 Mbi gjysma e stafit akademik të Universitetit kanë kryer doktoraturën dhe kanë titullin Profesor ose Profesor i Asociuar, gjë që tregon përfshirjen e tyre në kërkim shkencor. **[RVV f.33; 3.27, 1.22]** Zhvillimi i programeve Master është i përqendruar në fushat ku ka staf akademik me kualifikim të lartë dhe ku ka potencial për partneritete në nivel kombëtar ose ndërkombëtar. Stafi akademik që jep mësim në programet e studimit të ciklit të dytë merr pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare/projekte dhe publikon kërkimet e veta. **[4.18]** Disa kërkime botohen gjithashtu brenda vendit, në revistat dhe buletinet e Universitetit. **[4.43]** Praktika profesionale është pjesë e programeve përkatëse, nëpërmjet

marrëveshjeve institucionale me organet publike vendore dhe me sektorin privat. **[RVV; 1.32; M6a; M6b]** Punëdhënësit nga sektori publik dhe privat janë gjithashtu të përfshirë në dhënien e feedback-ut për programet e studimit dhe, ndonjëherë, për miratimin e programeve të reja. **[M6b]** Universiteti ka krijuar një bazë të dhënash për të mbajtur detajet e vendeve ku punësohen të diplomuarve dhe detajet e punësimit, por kjo ende nuk është menaxhuar në mënyrë sistematike dhe informacioni është i kufizuar (shih gjithashtu pikat 1.15 dhe 5.16). **[FE1.9; M9; 3.32] [Kapitulli I Standardi I.9]**

3.10 Në përputhje me ambiciet e universitetit për ndërkombëtarizimin, të gjitha programet e diplomave të ofruara nga Universiteti përfshijnë kurse të gjuhëve të huaja në kuadër të kurrikulës së tyre **[RVV f.34]** dhe Universiteti po punon për ta pasur të gjithë informacionin e programit të studimit në gjuhën angleze dhe shqipe. **[RVV f.34]** Informacioni që gjendet në shtojcën e diplomës paraqitet në gjuhën shqipe dhe angleze. **[3.33]** Studentëve u kërkohet të marrin një provim për nivelin e gjuhës angleze përpara se të përparojnë në programet e ciklit të dytë ose të tretë. **[3.16; 3.17]** Ka pasur një sërë marrëveshjesh dhe projektesh të përbashkëta për mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus + dhe mobiliteti nxitet nëpërmjet futjes së seancave të gjuhëve të huaja dhe transferimit të krediteve. **[M3; 3.35; 1.32.1] [Kapitulli I Standardi I.10]**

3.11 Programet e studimit synojnë të balancojnë teorinë dhe praktikën, nëpërmjet përfshirjes së ushtrimeve praktike, udhëtimeve në terren dhe klasave laboratorike, për të mbështetur leksionet, dhe kjo është përshkruar qartë në syllabus. **[3.6.1-3.6.8, 3.38]** Shumica e programeve të ciklit të parë dhe të të gjithë ciklit të dytë përfshijnë modulet e punës dhe universiteti po shqyrton aktualisht ato që nuk kanë, me synim përfshirjen e zhvillimit të praktikës profesionale **[RVV fq.35]** Universiteti ka marrëveshje me organizatat e sektorit publik dhe privat, të cilat ofrojnë praktika dhe mundësitë e vendosjes. **[RVV fq.34; 3.30]** Përveç kësaj, Universiteti kërkon të përgatisë studentët për punësim, duke ofruar module të posaçme që lidhen me praktikën profesionale si në ciklin e parë ashtu edhe në ciklin e dytë bazuar në kërkesat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) akti nënligjor nr. 15. **[3.7; RVV fq.35] [Kapitulli I Standardi I.11; Kapitulli I Standardi I.12]**

3.12 Sistemi i krediteve lehtëson kalimin ndërmjet studimeve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme, dhe studentët mbështeten në këtë drejtim. **[3.36]** Studentët nxiten të marrin pjesë në konferenca ose të publikojnë dokumente kërkimore së bashku me stafin akademik. **[FE3.4]** Studentët, të mbështetur nga stafi, kanë marrë pjesë në aktivitetet e komunitetit, **[M5a]** ndonëse universiteti pranon se aspektet shoqërore dhe kulturore të jetës së universitetit nuk janë të mirëzhvilluara. **[RVV fq.35] [Kapitulli I Standardi I. 11]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm në proces.

- puna që po ndërmerret nga universiteti për të forcuar shërbimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës (pika 3.2; **Kapitulli I Standardi I.2**).

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4 Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Struktura e programeve të studimit është e autorizuar nga rregulloret specifike të fakultetit, **[FE4.6; përkthimi i 4.1 dhe 4.2]** të cilat janë në përputhje me kërkesat universitare dhe shtetërore. Përmbajtja e programit përcaktohet në nivelin e departamentit dhe i kushton vëmendjen e duhur nevojave të studentëve në drejtim të llojeve të shërbimeve, për shembull udhëtime në terren, vizita studimore dhe klasa laboratorike. **[FE1.6]** Nevojat e disiplinës merren gjithashtu parasysh, për shembull, për sa i përket ofrimit të trajnimeve profesionale (praktika) **[RVV; M5a; M6b]** Praktikantët janë të siguruara, nëpërmjet marrëveshjeve formale, **[3.30]** dhe mësimi monitorohet siç duhet nga universiteti **[4.8; 4.9]** Universiteti ofroi shembuj që tregojnë se praktikantët janë menaxhuar mirë, dhe është treguar kujdes për të vërtetuar arritjet e studentëve. **[FE1.8]** Universiteti tregon vetëdijen për kapacitetin e vet në mbështetjen e studentëve; për shembull, Senati kohët e fundit kërkoi nga Bordi i Administrimit leje për të rekrutuar staf të ri akademik prej 70 vetash, **[AE3]** në përputhje me Strategjinë e Universitetit **[AE2, f.5] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.2 Studentët regjistrohen në module dhe kanë akses në oraret e tyre, nëpërmjet internetit. **[RVV f.36]** Mbahen regjistrat e pjesëmarrjes **[p.sh. 4.5]** dhe të dhënat përdoren në përputhje me rregullat e universitetit. **[1.10]** Studentët e anketuar për këtë rishikim përgjithësisht ishin të kënaqur me metodat e mësimdhënies, organizimin e kurrikulës, cilësinë e stafit mësimdhënës dhe ofrimin e literaturës mbështetëse **[Anketim]**, por ata që u takuan me Grupin e Vlerësimit dhanë përgjigje të ndryshme për përshtatshmërinë e literaturës mbështetëse **[5a; 5b]** Rritja e bibliotekës është pjesë e strategjisë së zhvillimit të Universitetit (shih gjithashtu pikën 5.10). **[RVV] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.3 Raporti i Vetëvlerësimit pretendonte shpërndarje të gjerë të rregullave të vlerësimit dhe diplomimit, dhe studentët konfirmuan se ata ishin në dijeni të rregullave dhe kërkesave të provimeve **[M5a; M5b]** Universiteti dha shembuj të rregullave dhe kërkesave të veta të kodifikuara në mënyrë të përshtatshme në rregulloren e Fakultetit të Shkencave Teknike, **[FE4.6 (përkthimi 4.2)]** dhe në atë të Fakultetit të Shëndetit Publik **[FE4.6 përkthim i 4.1]**. Kërkesat e këtyre të fundit nuk janë aq të plota sa të parat, meqë proceset e ankesave dhe apeleve nuk janë deklaruar dhe Universiteti mund të dëshirojë ta marrë parasysh këtë. **[Kapitulli I Standardi II.2]**

4.4 Studentët i pohuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se ata janë pajisur me diploma, përfshirë edhe suplementet e diplomës. **[M5b]** Kriteret e diplomimit përcaktohen nga fakultetet **[4.1; 4.2]** dhe miratohen nga Senati. **[3.37]** Procedurat e mbrojtjes së diplomës së ciklit të parë dhe të dytë ndryshojnë pak në fakultete të ndryshme, **[4.10; 4.11; 4.12; 4.13]**, por janë në përputhje me kriteret. **[Kapitulli I Standardi II.2]**

4.5 Rezultatet e provimit shpallen brenda 48 orëve nga provimi **[RVV]** dhe studentët kanë akses në to në mënyrë elektronike. **[M2; M5a; M5b]** Nëse sistemi nuk punon, rezultatet e provimit bëhen të disponueshme në mënyrë konfidenciale nga pedagogu i kursit. **[RVV]** Një grup i vogël studentësh të anketuar për këtë vlerësim vuri në dukje se në përgjithësi ka pasur transparencë në vlerësime dhe provime dhe vlerësimi i studentëve ka qenë i saktë. Megjithatë, studentët mund të kërkojnë shpjegime për rezultatet e tyre të provimit dhe në fund të fundit të bëjnë ankesë, e cila vlerësohet nga një komision i ngritur për këtë qëllim

[p.sh. 4.17] megjithëse disa studentë që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, nuk ishin në dijeni të procesit. Ende nuk garantohet sekretimi gjatë korigjimit të provimeve, edhe pse Departamenti i Infermierisë po krijon “Komisione konfidenciale”, për të mbikëqyrur korigjimin anonim **[FE4.13]** dhe kjo mund të jetë një model që mund ta ndjekin edhe departamentet e tjera. Universiteti nxitet të shqyrtojë dobinë e këtij modeli me qëllim zbatimin e tij në të gjithë institucionin. **[Kapitulli I Standardi II.2]**

4.6 Më shumë se gjysma e studentëve të anketuar për këtë vlerësim kanë raportuar se studentët kopjojnë në provime. Në vitin 2015 Këshilli i Fakultetit të Shëndetit Publik vuri në dukje se kopjimi në provime ishte një zakon i përhapur dhe ndikoi shumë në ecurinë e duhur akademike dhe vlerësimin e studentëve **[AE14]** dhe ranë dakord të zbatojnë masa ndëshkuese për studentët e kapur. Universiteti ka rregulla të përshtatshme në kuptimin që rregullorja **[1.2 Neni 74]** përcakton se Dekanati përkatës është përgjegjës dhe cakton ndëshkimet në përputhje me Kodin e Etikës. Megjithatë, universiteti duhet të vazhdojë të jetë vigjilent në lidhje me kopjimin dhe të sigurojë zbatimin e dënimeve të përshtatshme. **[Kapitulli I Standardi II.2]**

4.7 Departamentet hartojnë raporte vjetore të bazuara në analiza në një mbledhje të stafit. **[M8]** Këto raporte vlerësojnë plotësinë e stafit akademik, duke marrë parasysh reagimet e studentëve dhe performancën në mësimdhënie dhe kërkim; **[FE4.6 përkthim i 4.1, fq.55]** vlerësojnë statusin e programeve të studimit; dhe japin udhëzime për të realizuar përmirësime dhe për të ruajtur vlerën aktuale **[p.sh. AE17]** Këto raporte kontribuojnë te raportet e fakulteteve në përpilimin e Raportit Vjetor të Universitetit, **[FE1.6; M8]** i cili paraqet një përmbledhje të dobishme të programeve të Universitetit dhe veprimtarisë akademike. Raporti Vjetor i Universitetit dhe ndryshimet kurrikulare që ai rekomandon miratohen nga Senati. **[AE16; M3] [Kapitulli I Standardi II.3]**

4.8 Çdo semestër, studentët anketohen online në lidhje me mendimet e tyre për stafin dhe programet e studimit. **[RVV; M5a; M5b]** Stafi dhe studentët përmendën shembuj ku feedback-u i studentëve kishte sjellë ndryshime në kurrikul. **[M3; M5a; M5b]** Studentët e anketuar për këtë vlerësim vunë në dukje se, në përgjithësi, metodat e mësimdhënies ishin të shëndosha, stafi ishte i angazhuar për punën e tij mësimore, i disponueshëm dhe i dobishëm **[Kapitulli I Standardi II.3]**

4.9 Raporti i Vetëvlerësimit vuri në dukje disa të dhëna për punësimin në Raportin Vjetor të vet, por vetëm për Fakultetin e Shëndetit Publik **[1.28]** Ndërsa Universiteti mban disa të dhëna për disa alumni të tij, **[FE1.9]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk mundi të gjente asnjë dëshmi të të dhënave që janë marrë në konsideratë nga Universiteti gjatë vlerësimit të cilësisë së programit [Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i kërkoi, por Universiteti nuk e vënë në dispozicion] **[Kapitulli I Standardi II.3]**

4.10 Kriteret e Universitetit për emërimin e stafit akademik **[FE6]** u japin rëndësi kandidatëve me doktoraturë, por megjithatë universiteti mbështet stafin pa doktoraturë, për të përfunduar studimet e doktoraturës. **[M2] [Kapitulli I Standardi II.4]**

4.11 Raporti i Vetëvlerësimit e përmendi Qendrën e të Nxënit Gjatë gjithë Jetës si aktive në mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, por megjithëse Qendra ishte përfshirë në trajnimin e stafit gjatë krijimit të qendrave të të mësuarit gjatë gjithë jetës, **[3.13]**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk konstatoi ndonjë evidencë të rolit të saj në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. **[M9] [Kapitulli I Standardi II.4]**

4.12 Universiteti pohoi se stafi akademik i nënshtrohet trajnimit për mësimdhënien dhe kjo u konfirmua nga stafi me të cilin u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, **[RV; M2]** i cili tregoi se ka kurse trajnimi, sidomos për stafin e ri, dhe se mentorimi i të cilit nga stafi më i me përvojë **[M8]** është pjesë e politikës së universitetit. Megjithatë, në përgjigje të kërkesës së Grupit të Vlerësimit për të parë materialet e trajnimit, universiteti vuri në dispozicion një listë të kurseve ndjekur nga pjesëtarë të stafit të Fakultetit të Shkencave Teknike në lidhje me çështje joakademike, ndonëse disa mund të konsiderohen të dobishme për të ndihmuar aftësitë kërkimore. **[AE12]** Për më tepër, stafi i lartë drejtues ka raportuar se Universiteti nuk trajnon stafin në mësimdhënie, mësimdhënie, dhe vlerësim **[M2; M8]**, stafi akademik nuk mund të jepte evidenca se si mbështeteshin për të eksperimentuar në mësimdhënie **[M8]** dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk mundi të gjente evidenca për një strukturë mbështetëse, që nxit përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, përfshirë mentorimin. Në vitin 2017, senati miratoi një model për vlerësimin dhe regjistrimin e performancës, duke përfshirë performancën e asistentëve akademikë nga drejtuesit e tyre **[M1; AE22; M8]** Ndonëse modeli është i përshtatshëm për këtë qëllim, ende nuk është vënë në praktikë. Mungesa e një skeme fillimisht për trajnimin e stafit të ri dhe më pas zhvillimin e stafit në mënyrë të vazhdueshme, për të përmirësuar mësimdhënien e tyre, përbën **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të zbatojë një sistem të efektshëm dhe procedurë shoqëruese për zhvillimin e stafit, duke përfshirë pedagogët e ciklit të parë, të dytë dhe të ciklit të tretë, në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikat më të mira aktuale. **[Kapitulli I Standardi II.4]**

4.13 Universiteti e konsideron rolin e kërkimit si mbështetje të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe pasurimit të përvojës nga studentët dhe stafi. Si i tillë, kërkimi është një përparësi e rëndësishme për universitetin. **[1.1,1.2,1.16]** Departamenti, si njësi themelore e mësimdhënies dhe kërkimit, organizohet në grupe mësimore dhe kërkimore dhe përcakton prioritetet e veta kërkimore. **[3.14; 4.26, FE1.6]** Secili anëtar i stafit akademik plotëson një formular për ngarkesën e punës, nënshkruar nga përgjegjësi i departamentit, ku specifikohen mësimdhënia, kërkimet, transferimi i njohurive dhe aktivitetet krijuese **[p.sh. 3.21]** Stafi vuri në dukje autonominë në vendosjen për temat e kërkimit të tyre, për sa kohë që këto tema përputheshin me drejtimin e përgjithshëm të departamentit. **[M3] [Kapitulli II Standardi I.1; Kapitulli II Standardi.6]**

4.14 Kërkesat për financimin e kërkimit miratohen nga departamentet **[M4]**, ose përndryshe në Senat dhe në Bordin e Administrimit, në bazë të prioriteteve të universitetit. **[M1]** Departamentet nga ana e tyre ofrojnë ndihmë financiare për stafin që ndërmerr veprimtarinë kërkimore **[AE1.6]** mbështetur në buxhetin vjetor të propozuar nga grupet e kërkimit. **[p.sh. 4.27]** Departamentet gjithashtu vlerësojnë veprimtarinë kërkimore **[p.sh. 4.28]** si mjet i shpërndarjes së fondeve **[RVV] [Kapitulli II Standardi I.1]**

4.15 Në projektstrategjinë e vet, **[AE2, fq.7]** universiteti citon ndërkombëtarizimin nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet e tjera të arsimit të lartë evropian si qëllimi kryesor i tij dhe stafi me të cilin u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishin në përgjithësi të vetëdijshëm për këtë prioritet **[M2; M3; M4; M8]** universiteti ka hartuar një Strategji të Ndërkombëtarizimit, duke i vënë theksin e duhur mobilitetit. **[1.20] [Kapitulli II Standardi I.3]**

4.16 Zyra e Projekteve, Investimeve dhe Shkencës ndihmon bashkëpunimin me organizata të tjera kërkimore, nëpërmjet, për shembull, projekteve Tempus dhe Erasmus + [1.31,1.35, 4.35, AE1.10b], në të cilat kanë marrë pjesë shumë pjesëtarë të stafit. Janë nënshkruar edhe marrëveshje të tjera bashkëpunimi me universitete ndërkombëtar. [p.sh. 4.31; 4.32, FE1.10a, 1.10c; AE5, f.2-3] Universiteti konsideron pjesëmarrjen në konferenca të rëndësishme për promovimin e universitetit, si në Shqipëri, ashtu dhe jashtë saj [FE1.6] dhe është veçanërisht aktiv në organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare. [RVV f.7; 4.35; AE2 f.3] Është vënë re pjesëmarrje e gjerë e stafit në konferencat jashtë shtetit, [FE4.16; AE17 f.140] dhe megjithëse që ka një procedurë për rimbursimin e kostove [2.9] vetëm një pjesë e vogël e pjesëmarrësve kanë rimbursuar [FE4.16; M3; M8] [Kapitulli II Standardi I.3; Kapitulli II Standardi.6; Kapitulli II Standardi.7]

4.17 Universiteti është aktiv në një sërë arenash në përkrahjen e bashkëpunimit, ndërkombëtarizimit dhe mobilitetit. Ai ka themeluar rrjetin e kërkuesve shqiptarë në diasporë dhe synon nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit deri në dhjetor të vitit 2017 me institucionet akademike dhe shkencore në nivel universitar me elementet e Diasporës. [4.33] Universiteti ka në plan të përfshijë module në anglisht, gjermanisht ose në të dyja gjuhët, në të gjitha programet e studimit. [M3] Ka pasur sukses modest në bashkëpunim në projekte që ose janë kërkime në natyrë ose mund të çojnë në kërkime, përfshirë INTERREG, EPACTT - 2, dhe Erasmus + [AE2 f.7; M2] Në përgjithësi, ka pjesëmarrje të lartë në projekte të jashtme, përfshirë ato evropiane, dhe aktivitete të tjera. [p.sh. 4.34, M2; M3] Një numër i vogël i stafit ka marrë pjesë në mësimdhënie jashtë vendit [4.42] dhe Universiteti ka pritur një numër të vogël të stafit akademik të huaj si vizitorë. [1.37] Universiteti mund gjithashtu të promovojë bashkëpunimin dhe ndërkombëtarizimin, duke dhënë çmime ose tituj nderi. [4.36; 4.37] [Kapitulli II Standardi I.3; Kapitulli II Standardi I.2; Kapitulli II Standardi I.6]

4.18 Për të vlerësuar nëse stafi realizon apo jo botime në revistat shkencore ndërkombëtare, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi një listë të rezultateve të tilla. Megjithatë, lista e dhënë [FE4.15] ishte e mangët dhe evidentoi se ndërsa numri i rezultateve është mbresëlënës, shumë prej tyre janë në Shqipëri dhe shumë të tjerë janë në revista pa reputacion ndërkombëtar. [gjithashtu AE17 fq.140-] Shumë kërkime janë botuar në revistën e vet të universitetit "Buletini Shkencor" [4.43], të cilat mund të dekurajojnë stafin nga botimi në revista ndërkombëtare. Stafi që u takua me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm [M8] nuk kishte ishte shumë i qartë për botimet ndërkombëtare dhe universiteti mund të dëshirojë të identifikojë mjetet për mbështetjen e botimeve në revista shkencore ndërkombëtare, duke rritur kështu promovimin e universitetit. [Kapitulli II Standardi I.3; Kapitulli II Standardi.7]

4.19 Senati i Universitetit ngriti një Komision për Kërkimin Shkencor dhe Projektet në vitin 2012. [AE21; M3] Për të kuptuar funksionin e tij, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi t'i vinin në dispozicion procesverbalin e tij për dy vitet e fundit. Këto procesverbale nuk u ofruan dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se komisioni nuk është mbledhur në dy vitet e fundit. Universiteti dëshiron të marrë në konsideratë sigurimin e një kontrolli institucional mbi veprimtarinë dhe strategjinë e tij kërkimore. [Kapitulli I Standardi I.4]

4.20 Universiteti ka themeluar një qendër kërkimore në Studimet Mjedisore [M8] dhe janë planifikuar edhe katër qendra të tjera kërkimore (një për fakultet). M1; M9; Qendrat do të mbështesin integrimin e kërkimit në mësimdhënie, [RVV] edhe pse është e paqartë se si do

të bashkëveprojnë me departamentet, si njësi themelore **[Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi.5; Kapitulli II Standardi.6]**

4.21 Në vitin 2016, Senati miratoi kritere të qarta bazuar në pikë për emërimin e stafit akademik të kalibrit të lartë **[AE6; M2]**, në të cilat kanë përparësi kandidatët që kanë kryer doktoratën e tyre jashtë vendit. Siç u përmend më lart, universiteti mbështet ata punonjës pa doktoraturë, për të përfunduar studimet e doktoraturës, duke përfshirë ofrimin e mbështetjes financiare. Megjithatë, universiteti pranon se shumë pak kërkues të rinj menaxhojnë projekte. **[1.19.1f.21]** Universiteti pohoi se studentët e ciklit të parë dhe të dytë marrin pjesë në kërkime, nëpërmjet projekteve kërkimore si pjesë e marrje së diplomës së tyre **[RVV]**. Megjithatë, studentët që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm **[M5a; M5b]** nuk mund të tregonin qartë rolin e tyre në veprimtarinë kërkimore, nuk ishin në dijeni të mjeteve themelore, për të kërkuar artikuj akademik dhe kishin akses vetëm në një numër shumë të kufizuar të teksteve të plota dhe artikujve. Megjithatë, në konferenca marrin pjesë një numër i konsiderueshëm i studentëve **[M5b]** brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe një numër shumë i vogël përfshihen si autorë në artikuj kërkimor. **[AE7] [Kapitulli II Standardi I.5; Kapitulli II Standardi.6; Kapitulli II Standardi.8]**

4.22 Realizohet vlerësimi i veprimtarive kërkimore në nivel individual **[M8]** që përpilohet në raporte vjetore të departamenteve, **[AE17 fq.140-]**, të cilat përdoren në përgatitjen e raporteve vjetore të fakultetit dhe të universitetit. Raporti Vjetor i Universitetit **[FE1.6]** i trajton kërkimet dhe në bazë të tij formulon një sërë qëllimesh dhe prioritetesh, për të shtuar kërkimet. Edhe pse këto janë të lavdërueshme, ato janë gjithashtu të shpërndara, nuk paraqesin objektiva të fuqishme, dhe do të jetë e vështirë për universitetin që të shqyrtojë se kur përmbushen ato. Universiteti pranon se pozicioni i tij në raport me kërkimin ka nevojë për përmirësim dhe përforsim, siç tregohet në projektstrategjinë e tij. **[AE2 fq.6]** Në veçanti, prioritetet e universitetit përfshijnë krijimin e infrastrukturës së përshtatshme kërkimore, për kërkim dhe botim dhe menaxhim kërkimor në nivel institucional. **[Kapitulli II Standardi I.8; Kapitulli II Standardi.4; Kapitulli II Standardi.2]**

4.23 Strategjia e Burimeve Njerëzore për Kërkuesit përvijon një sërë çështjesh lidhur me shkallën se sa janë të kënaqur kërkuesit dhe ka vendosur mjete për adresimin e tyre nëpërmjet një plani veprimi. **[1.19.1 fq.20-]** Ka shqetësime për mungesën e trajnimit, koordinimit, mbështetjes financiare (stafi përdor fondet e tij) dhe transparencës, dhe për pengesat burokratike. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** hapat që Universiteti ka filluar të ndërmarrë për të trajtuar mbështetjen për kërkuesit, që rrjedh nga plani i veprimit në Strategjinë e Burimeve Njerëzore për Kërkuesit. **[Kapitulli II Standardi I.8]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e një skeme si për trajnimin fillimisht të stafit të ri dhe stafit ekzistues, për të përmirësuar në vazhdimësi mësimdhënien e tyre (pika 4.12; **Kapitulli I Standardi II.4**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Universiteti të zbatojë një sistem të efektshëm dhe procedurën shoqëruese për zhvillimin e të gjithë stafit mësimdhënës, për përfshirjen e pedagogëve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikatat më të mira aktuale (pika 4.12; **Kapitulli I Standardi II.4**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimet e mëposhtme që po ndërmerren:

- hapat që universiteti ka filluar të ndërmarrë për të adresuar mbështetjen për kërkuesit, që rrjedh nga plani i veprimit në Strategjinë e Burimeve Njerëzore për Kërkuesit (pika 4.23; **Kapitulli II Standardi I.8**).

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Universiteti ka struktura, politika dhe procedura për menaxhimin e përvojës së të nxëniet të studentëve dhe sigurimin e mbështetjes për studentët, duke filluar nga para regjistrimit në universitet e deri në punësim. Pranimi në universitet kryhet në përputhje me legjislacionin e qeverisë [Ligji nr. 80/2015, nenet 74, 76 dhe 78] dhe me kriteret e përcaktuara në Statut dhe Rregullore, si dhe kriteret e propozuara nga departamentet dhe miratuar nga Senati. [RVV fq.43; 1.1 Neni 25; 1.2 Neni 39; 3.5; 3.5.1] Kriteret e pranimit të miratuara nga Senati janë të publikuar në faqen e internetit të universitetit, e cila ofron informacion për studentët e ardhshëm dhe palët e tjera të interesit. [1.23; <http://univlori.edu.al/arkiva/8286>] [Kapitulli I Standardi III.1]

5.2 Qendra e Këshillimit Studentor është një zyrë qendrore që këshillon studentët rreth regjistrimit, rregulloreve universitare, mënyrën e zgjedhjes së moduleve, pjesëmarrjen në organizatat studentore dhe mbështetjen financiare. [RVV fq.43; 1.16 fq.13; FE1.3.b] Universiteti mban kontakte me Drejtorinë Rajonale të Arsimit dhe organizon ditë të hapura çdo vit për studentët e shkollave të mesme. [2.7] Stafi akademik nga katër fakultetet i viziton shkollat e mesme dhe i këshillon studentët e shkollave të mesme të vitit të fundit në lidhje me programet e studimit dhe arsytet pse duhet të zgjedhin Universitetin e Vlorës. Studentët e ardhshëm mund edhe ta vizitojnë universitetin. [M5a; 3.2] Nga Qendra e Komunikimit dhe Botimeve është përgatitur dhe publikuar një udhëzues për studentët. [M9; 2.7] Sekretaritetë e departamenteve janë përgjegjëse për procesin e regjistrimit; studentët pajisen me një emër përdoruesi dhe fjalëkalim për të hyrë në sistemin online. [1.2 Rregullore e UV, art. 54 dhe 55] Të dhënat e studentëve menaxhohen në mënyrë të efektshme dhe studentët janë të kënaqur me informacionin e marrë në lidhje me programet e studimit, rregullimin dhe jetën studentore. [M5a] [Kapitulli I Standardi III.1; Kapitulli I Standardi III.2; Kapitulli I Standardi III.3]

5.3 Si pjesë e Strategjisë së tij të Ndërkombëtarizimit, [1.20 nr. 78] Universiteti mirëpret studentët e huaj në të gjitha ciklet e programeve të studimit. Mobiliteti lehtësohet nëpërmjet marrëveshjeve ndëruniversitare sipas Erasmus + dhe nëpërmjet njohjes së studimeve dhe procedurave të ekuivalentimit të notave [1.1 Neni 32] [1.2 Neni 58; 1.35] Aktualisht po zbatohen marrëveshjet ndëruniversitare në kuadrin e programit Erasmus +, dhe studentët e përfshirë në programet e shkëmbimit, që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, përfituan nga pjesëmarrja në kurset që u ofruan në gjuhën angleze. [M5b] Universiteti gjithashtu ndjek një politikë të përpjekjes, për të tërhequr studentë nga diaspora shqiptare, përveç studentëve të tjerë ndërkombëtarë. [4.33 Vendimi Nr.77] [Kapitulli I Standardi III.1]

5.4 Studentët marrin informacion dhe këshillim nëpërmjet një sërë zyrash administrative, në veçanti nëpërmjet Qendrës së Këshillimit Studentor, Zyrës së TI-së dhe Statistikave, dhe Sekretarive të Departamenteve. [1.3.b] Përveç kësaj, këshilluesi akademik i studentëve luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e studentëve të rinj në programet e tyre, [1.2 Neni 85] një rol që në strukturën e re organizative zëvendësohet nga koordinatori i marrëdhënieve të studentëve. [1.16 f.21] Qendra e Këshillimit Studentor punon ngushtësisht me koordinatorët në çdo fakultet dhe departament. [M2] [Kapitulli I Standardi III.2]

5.5 Stafi akademik duhet të jetë i disponueshëm për konsultime me studentët në zyrën e tyre çdo javë në oraret e publikuara, si pjesë e ngarkesës vjetore të punës (shih gjithashtu pikën 5.12). **[1.2. Neni 83; M8]** Në shërbim të studentëve, orët e hapjes për të gjitha shërbimet administrative shfaqen gjithashtu në ambientet përreth Universitetit. **[M9] [Kapitulli I Standardi III.1]**

5.6 Bazuar në propozimet e Senatit, MAS miraton numrin e studentëve që do të pranohen në çdo program studimi. Kuotat e miratua bazohen në të ardhurat e vitit të kaluar dhe në numrin e kërkesave. Në Universitetin e Vlorës numri i studentëve të rinj të regjistruar ka qenë pothuajse i njëjtë gjatë dy viteve të fundit akademike. **[GID]** Në përgjithësi, raporti stafit akademik-student duket se është 1:32, ndonëse kjo ndryshon në varësi të departamentit, duke qenë se disa që kanë një raport shumë të lartë. Të gjitha organet vendimmarrëse janë të vetëdijshme për kufizimin e raportit staf-studentë. **[5.2; M1; M4]** Qëllimi i Universitetit është rritja e numrit të studentëve në tre vitet e ardhshme, por deri më sot shtimi kufizohet nga infrastruktura dhe nga numri i stafit akademik. **[M1]** Megjithatë, ligji i ri i Arsimit të Lartë mundëson që universiteti të përcaktojë numrin e stafit të tij, ndërsa Senati dhe Bordi i Administrimit kanë marrë vendimin për rritjen e numrit të stafit akademik me 70 vetë në tre vitet e ardhshme; aktualisht janë duke u ndërmarrë hapa për ta adresuar këtë dhe rekrutimet e reja do të fillojnë pas miratimit të buxhetit afatmesëm. **[M1; AE70; M4]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** hapat që po ndërmerren nga Universiteti për të përmirësuar raportin staf-studentë. **[Kapitulli I Standardi III.1]**

5.7 Universiteti përdor mjete të ndryshme për komunikim të jashtëm dhe të brendshëm. Njoftimet (për shembull për oraret e orëve mësimore, kurrikulat e lëndëve, regjistrimin në provime, aplikimet për stazh, bursat, aktivitetet, tarifat e shkollimit dhe përjashtimet nga tarifa) publikohen gjithmonë në faqen zyrtare të internetit të Universitetit, i cili është lehtësisht i aksesueshëm. **[<http://univlora.edu.al/main>]** Informacioni, që mund të ketë nevojë për shpjegime të mëtejshme të ofruara nga stafi, jepet nga Zyrat e Informacionit dhe/ose njësitë e tjera administrative. **[RVV f.45; M9]** Përveç kësaj, stafi akademik dhe studentët përdorin edhe emailin. Llogaritë elektronike ofrohen përmes sistemit të komunikimit online, ESSE3, i cili siguron një mjet të efektshëm komunikimi për studentët dhe stafin e Universitetit. **[<https://www.univlora.esse3.u-gov.rash.al>]** Secili fakultet mban një dosje personal për secilin student, që përmban adresën, adresën e emailit, numrat e telefonit, dëftesat e shkollës së mesme dhe të dhëna të tjera. Dosjet e studentëve ndjekin ecurinë individuale të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim dhe menaxhohen nga Sekretaria. **[RVV f.45; 1.10] [Kapitulli I Standardi III.2]**

5.8 Qendra e Këshillimit Studentor jep këshillim për studentët e të gjitha cikleve të studimit dhe mbështet kalimin nga një cikël studimi në tjetrin. Universiteti i jep prioritet të diplomuarve të vet, kur aplikojnë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë **[RVV fq.46; 5.4]** Qendra ofron trajnime dhe seminare për përgatitjen e CV; panairë pune dhe përkrahje për sigurimin e intervistave për punë; këshillim rreth programeve të ciklit të dytë; informacion rreth praktikave dhe mundësive të punësimit, programeve të shkëmbimit dhe periudhave të studimit jashtë vendit; dhe asistencë gjatë proceseve përkatëse të aplikimit. **[M5a; M5b]** Ka procedura funksionale që u lejojnë studentëve të ndryshojnë programet studimore brenda dhe jashtë Universitetit dhe ofrohet mbështetje për studentët që dëshirojnë ta bëjnë këtë. **[1,1; 1.2; 3.34; 5.3] [Kapitulli I Standardi III.3]**

5.9 Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi [VKM Nr. 699, datë 22.10.2014, VKM Nr. 911, datë 11.11.2015 dhe VKM Nr. 903, datë 21.12.2016] studentëve nga “grupet e cenueshme” (përfshirë ata me aftësi të kufizuara, romë dhe ballkano-egjiptianë dhe studentët nga familjet me të ardhura të ulëta) iu është ofruar përkrahje, nëpërmjet heqjes së pagesës së plotë ose të pjesëshme të tarifave të shkollimit. [5.5; RVV fq.46; FE5.2] Përfshirimi nga tarifat iu ofrohet gjithashtu studentëve ekselentë. [M4; M5b] Rampat për të lehtësuar lëvizshmërinë e studentëve me aftësi të kufizuara ofrohen vetëm në një ndërtesë. [Turi në ambientet e universitetit] Objektet sportive të universitetit janë shumë të kufizuara dhe me standarde të ulëta, por studentëve që luajnë sport u është dhënë mbështetje, duke i pajisur ata me uniforma [M4] dhe në vitin 2011 fituesit e maratonës së studentëve janë përfshirë nga tarifat e shkollimit. [RVV fq.46; 5.6] Universiteti nuk ofron më programe me kohë të pjesëshme që prej vitit 2014 në përputhje me legjislacionin shqiptar, por studentët e regjistruar do të mbështet deri në përfundim të studimeve të tyre. [3.12] [Kapitulli I Standardi III.4]

5.10 Universiteti ka një bibliotekë qendrore në Ndërtesën e Rektoratit dhe një tjetër në Fakultetin e Shkencave Humane. Biblioteka qendrore është shumë e vogël (250 m²) dhe ka një volum të kufizuar librash; shumica janë në anglisht dhe janë shumë të vjetër. [Turi në ambientet e universitetit] Biblioteka ka rreth 15,000 tituj, gjithsej 35,000 tekste në format të shtypur. Biblioteka nuk ka libra elektronikë. Po kryet digjitalizimi, por vetëm në lidhje me indeksimin. Biblioteka varet kryesisht nga donacionet për stokun e librave. [<http://univlor.edu.al/portfolio/biblioteka>] Universiteti është i vetëdijshëm se burimet e bibliotekës janë shumë të kufizuara dhe se literatura duhet të përditësohet. Departamentet paraqesin propozimet e tyre për burimet e bibliotekave, por kërkesat për fonde shtesë të bibliotekës nuk lidhen me numrin e studentëve që ndjekin kursin. Planifikimi i buxhetit përfshin burimet e bibliotekave; megjithatë, fondet në dispozicion bëjnë të mundur blerjen e disa kopjeve. [M9; M5a] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon hapat që po ndërmerren për t'i alokuar bibliotekës buxhetin, nëpërmjet mekanizmave të buxhetimit të Universitetit, dhe për të pasuruar stoqet e bibliotekës, nëpërmjet donacioneve, në mënyrë që të mbështesë në mënyrë të efektshme mësimin dhe kërkimin e studentëve. [Kapitulli I Standardi II.5]

5.11 Informacioni rreth bibliotekave dhe veprimtarive të tyre publikohen në faqen e internetit të Universitetit. [<http://univlor.edu.al/en/portfolio/biblioteka>; 5.8] Orët e hapjes së bibliotekës shpallen në ambientet e universitetit dhe publikohen në faqen e internetit të Universitetit. [5.9] Biblioteka është e hapur prej orës 8 deri në orën 16 nga e hëna deri të premten, ndërsa në fundjavë është mbyllur, [RVV fq.47] e cila kufizon aksesin për stafin dhe studentët jashtë orarit të leksioneve. Studentëve u jepet një kartë regjistrimi që u lejon atyre të përdorin të gjitha burimet e bibliotekës. [5.10] Universiteti ka krijuar një Qendër të re të Shërbimit të Librit, për të mbikëqyrur punën e dy bibliotekave. [1.16 fq.14] [Kapitulli I Standardi III.5]

5.12 Siç konstatohet në pikën 5.5 më lart, stafi akademik në të gjitha fakultetet publikon orarin e punës kur janë të disponueshëm për të takuar studentët dhe të japin këshilla personale ose akademike. Orari i çdo pedagogu përcaktohet në fillim të vitit akademik, kur përcaktohet edhe ngarkesa e punës. Secili person ka tre orë punë zyre çdo javë. Në periudhën para sezonit të provimeve, mund të organizohen orë konsultimi shtesë. [M8] Këshilluesit akademikë në çdo fakultet sigurohen që studentët e kuptojnë programin e tyre të studimit. [1.2 neni 85] Çdo modul ka një listë me materiale referencë, të cilat përditësohen

nga Departamenti dhe studentëve u jepen udhëzime për gjetjen e literaturës nga pedagogu i kursit të tyre dhe nga udhëheqësi i tyre në lidhje me punën e tyre kërkimore. **[3.10]** Kur është e mundur, Universiteti bën përshtatje për studentë me nevoja të veçanta mësimore, duke dhënë shembullin e dy studentëve me dëmtime në shikim, për të cilët ishte miratuar një formë tjetër vlerësimi. Stafi akademik pohoi se pedagogët zhvillojnë orë konsultimi shtesë për studentët, rezultatet akademike të të cilëve janë të dobëta. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi këtë si praktikë gjerësisht të përhapur. **[RVV fq.48; M8; 5.11 Vendimi nr.38]** **[Kapitulli I Standardi III.6]**

5.13 Universiteti nxit pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje. Sipas legjislacionit të mëparshëm, studentët u përfaqësuan në të gjitha organet e larta vendimmarrëse të Universitetit, përfshirë Senatin, Këshillin e Administrimit, Këshillin e Fakultetit dhe organet zgjedhore. Në përputhje me kornizën e re ligjore, studentët përfaqësohen vetëm në Senat (dy anëtarë). Megjithatë, zëri i tyre dëgjohet nga Bordi i Administrimit nëpërmjet kësaj rruge. Njoftimet për vendimet e Senatit afishohen në ambientet e fakultetit për informimin e stafit dhe të studentëve. **[5.12 Vendimi nr. 30; 5.13 Vendimi nr.39, M3, M4]** Studentët mund të japin mendime për kurrikulën e tyre, mësimdhënien dhe mbështetjen e studimeve dhe përfshihen në përmirësimin e programeve të studimit. Studentët të cilët u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm treguan rastet, kur feedback-u që kishin dhënë, kishte sjellë ndryshime në kurrikula, siç është kërkesa për module shtesë të gjuhës së huaj dhe ndryshimet në programin e studimit të Masterit të Shkencave në Infermieri **[4.3; 4.20; M3]** **[Kapitulli I Standardi III.7]**

5.14 Sigurimi i pjesëmarrjes së studentëve në qeverisjen universitare është parashikuar në statutet dhe rregulloret e Universitetit. **[1.1 Neni 37; 1.2 Neni 72]** Megjithatë, Këshilli Studentor nuk funksionon prej disa vitesh. Studentët pohuan se po zhvilloheshin zgjedhjet për Këshillin Studentor dhe se procesi do të përfundonte shumë shpejt. **[RVV fq.48; M5a, M5b]** Studentët të cilët u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, e kuptonin rolin që duhet të luajnë përfaqësuesit e tyre në parashtrimin e pikëpamjeve të tyre në Senat. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** hapat që ndërmerren për themelimin e Këshillit Studentor, i cilin do të formalizojë dhe përmirësojë komunikimin midis studentëve dhe organeve vendimmarrëse të universitetit. **[M5a]** **[Kapitulli I Standardi III.7]**

5.15 Universiteti mbështet dhe inkurajon aktivitete kulturore dhe sociale për studentët e tij. Fakultetet ofrojnë një sërë aktiviteteve ekstrakurrikulare, si panairt e punës, takimet me alumni, “studenti i vitit” dhe “ditët e studentëve të shkëlqyer”, dhe aktivitete shoqërore dhe komunitare, **[M5a]** Përveç kësaj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua për fushatat e trajnimit dhe ndërgjegjësimin të organizuara në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe me organizata të tjera të shëndetësisë. **[<http://univlor.edu.al/en/arkiva/5793>]** **[Kapitulli I Standard III.8]**

5.16 Qendra e Këshillimit Studentor u ofron studentëve një sërë shërbimesh, siç është u përmend në pikën 5.8. **[M5b]** Përveç kësaj, Qendra luan një rol në mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për punësimin e studentëve. **[RVV f.46; 5.4 Vendimi nr.50]** Është krijuar një bazë të dhënash për këtë proces, por është në një fazë shumë të hershme (shih gjithashtu pikën 1.15). **[M9]** Universiteti ka zbatuar një politikë pozitive të punësimit, duke punësuar të diplomuarit i universiteti dhe universiteteve të tjera të vendit. Universiteti ka rekrutuar 126 e

të diplomuarve të tij si staf akademik dhe joakademik (79 dhe 47 përkatësisht). [1.30]
[Kapitulli I Standardi III.9]

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e mëposhtme që po ndërmerren:

- hapat që po ndërmerr universiteti për të përmirësuar raportin pedagog-studentë (pika 5.6; **Kapitulli I Standardi III.1**)
- hapat që po ndërmerren për t'i alokuar bibliotekës buxhetin, nëpërmjet mekanizmave të buxhetimit të universitetit, dhe për të pasuruar bibliotekën me anë të donacioneve, që të mbështesin në mënyrë të efektshme mësimnxënien dhe kërkimin shkencor të studentëve (pika 5.10; **Kapitulli 1 Standardi II.5**)
- hapat që po ndërmerren për themelimin e Këshillit Studentor, i cili do të formalizojë dhe përmirësojë komunikimin midis studentëve dhe organeve vendimmarrëse të Universitetit (pika 5.14; **Kapitulli I Standardi III.7**).

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Lista e dokumenteve

RVV

Renditja	Nr. i dokumentit	Titulli
4	1.1	Statutet e Universitetit
5	1.2	Rregullorja e Universitetit të Vlorës
6	1.7	Rregullorja e Këshillit të Profesorëve
7	1.10	Miratimi i rregullores
8	1.11	Vendimi nr. 46
9	1.11.1	Rregullorja e programit ESS3
10	1.12	Vendimi nr. 40 Statuti i Ri dhe Rregullorja e UV
11	1.14	Rregullorja e Studimeve Doktorale
12	1.16	Struktura e re
13	1.18	Ngritja e grupit të punës për strategjinë
14	1.19.1	Strategjia e Burimeve Njerëzore
15	1.25	Ndryshimet në Kodin e Etikës
16	1.34	Marrëveshjet e bashkëpunimit
17	2.1	Miratimi i numrit të stafit akademik me kohë të pjesshme dhe stafit të ftuar
18	2.3	Miratimi i dhënies së titullit akademik "Profesor i asociuar"
19	2.4	Përcaktimi i kategorive të stafit mbështetës, akademik dhe administrativ
20	2.5	Komisioni i vlerësimit dhe konvertimit të notave
21	2.6	Miratimi i kriterëve të përzgjedhjes dhe procedurat e konkurrimit dhe vlerësimit për aplikim për pozicionin e stafit akademik me kohë të plotë
22	2.12	Analiza ekonomike dhe financiare dhe administrativo-menaxheriale për vitin 2015
23	2.13	Shpërndarja e raportit të inspektimit
24	2.15	Miratimi i programit të transparencës (informacioni i publikuar dhe mbrojtja e të dhënave)
25	3.1	Lista e programeve të studimit nga secili fakultet
26	3.5	Kërkesa për pranimin e studentëve për vitin akademik 2017-2018
27	3.5.2	Kriteret e pranimit në studimet e doktoratës
28	3.6.1	Bachelor në Infermieri
29	3.6.2	Bachelor në Biologji
30	3.6.3	Bachelor në Anglisht
31	3.6.4	Bachelor në Ekonomi
32	3.6.5	Master Profesional në Biologji
33	3.6.6	Master Profesional në Infermieri
34	3.6.7	Master i Shkencave në Administrim Biznesi
35	3.6.8	Master i Shkencave në Gjuhën Shqipe dhe Letërsi
36	3.6.9	Doktoratë në Matematikë
37	3.11	Qendra e Trajnimit Detar
38	3.16	Vendimi i Senatit për Gjuhën Angleze në Programet e Dytë të Ciklit
39	3.17	Vendimi i Senatit për Gjuhën Angleze në Programet e Ciklit të Tretë
40	3.24	Shembull i kriterëve të pranimit për programet e nivelit master
41	3.25	Shembull i programit të orientuar në tregun e punës
42	3.28	Krijimi i grupit të punës për rishikimin dhe konceptimin e

		programeve të studimit
43	3.29	Vendimi i Senatit për kualifikimet e stafit mësimdhënës
44	3.34	Vendimi i Këshillit të FSHT për ekuivalentimin për transferim kreditësh
45	3.37	Vendimi i Senatit për diplomimin me mbrojtjen e tezës
46	3.38	Programet e studimeve në Inxhinieri, Shkenca Natyrore dhe Mjekësore
47	4.4	Urdhër për sistemin PDF në mungesë të sistemit të menaxhimit të universitetit
48	4.7	Laboratorët e Fakultetit të Shëndetit Publik
49	4.14	Procedurat për Botimet Universitare
50	4.23	Miratimi i Rregullores së Qendrës Kërkimore të Shëndetit Publik
51	4.25	Krijimi dhe funksionet e Njesisë së Sigurimit dhe Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë
52	4.28	Veprimtaria Kërkimore-Shkencore e UV-së për vitin akademik 2015-2016
53	4.31	Projekt marrëveshja midis UV dhe TEI të Kretës
54	4.32	Memorandum mirëkuptimi midis FSHP dhe Laboratorit të Universitetit Jon të Greqisë
55	4.33	Rrjeti i Kërkuesve Shqiptarë në Diasporë (RKSHD)
56	4.45	Shërbimet në Komunitet
57	5.3	Një shembull i procedurës së transferimit nga Fakulteti i Ekonomisë
58	5.11	Vendimi "Për një sezon provimi shtesë në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali""
59	5.12	Vendimi "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit Akademik dhe strukturës numerike të Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali""
60	5.13	Vendimi "Për miratimin e dy anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Institucionale të Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali""
61	5.6	Vendimi "Për miratimin e propozimit të Zyrës së Marketingut në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali""
62	1.19	Mbështetja e Kartës Evropiane për Kërkuesit
63	1.6	Rregulloret për Departamentet dhe Fakultetet
66	2.14	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit-SMI Univlora
67	2.16	Ndërtesa C, projekt ndërtimi
68	2.17	Ndërtesa A, projekti rindërtimi
69	2.18	Auditori "Rilindja"
70	2.19	Ndërtesa B, projekti i rindërtimit
71	2.22	Regjistrat
72	3.15	Faqja online e Departamentit të Matematikës (fotografi e ekranit)
73	4.5	Regjistri i veprimtarisë mësimore, shembull
74	5.8	Udhëzues i Bibliotekës
75	5.9	Orari i Bibliotekës
76	5.10	Karta e Regjistrimit (për studentë)
77	1.32	Marrëveshjet e brendshme të UV
78	1.33	Marrëveshja e mobilitetit
79	2.2	Procedura e rekrutimit të stafit akademik
80	2.4b	Shembull i rekrutimit akademik
81	2.7	Lista e Aktiveteve të Zyrës së Këshillimit Akademik për vitin

		2015-2016
82	2.8	Lista e trajnimeve dhe certifikatave
83	2.9	Procedura e rimbursimit të konferencës
84	2.10	Procedura e propozimit të buxhetit
85	2.21	Çmimi i ofruar për analizën e mostrës së gazit
86	3.2	Dita e informacionit
87	3.8	Shembuj të Raportit të Vetëvlerësimit
88	3.9.1	Ristrukturimi i programeve të studimit në Infermieri
89	3.9.2	Ristrukturimi i Programit Bachelor në Navigacion
90	3.9.3	Procedura e rishikimit të programeve Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave, Edukimi në Vazhdim
91	3.9.4	Rishikimi i programit të studimit në Fakultetin e Shkencave Humane
92	3.10	Shembull i programit
93	3.13	Strategjia e UV 2008-2013
94	3.18	Projekti Amici i Planit të Veprimit
95	3.23.1	Procedura e hapjes dhe miratimit të programit Bachelor në Histori-Gjeografi
96	3.23.2	Procedura e hapjes dhe miratimit të programit Master Profesional në të Drejtën Penal
97	3.23.3	Procedura e hapjes së programit të ri të studimit FSHP
98	3.23.4	Procesi i konceptimit dhe miratimit të programit Master Profesional (MP) në Marketing
99	3.23.5	Procesi i konceptimit dhe Miratimit SpM. Biologji_Anglisht
100	3.26	Stafi akademik në programet e studimeve të ciklit të parë
101	3.30	Lista e marrëveshjeve profesionale
102	3.32	Stafi akademik. Programi e ciklit të dytë
103	3.33	Programet e studimit me suplement diplome
104	3.35	Njohja e krediteve të mobilitetit në kuadër të ERASMUS
105	3.36	Shembuj të transferimit të studimeve
106	4.10	Shembull i procedurës së mbrojtjes së diplomës për programin e ciklit të parë, Fakulteti i Shkencave Teknike
107	4.12	Shembull i procedurës së mbrojtjes së diplomës, Fakulteti i Ekonomisë
108	4.13	Shembull i procedurës së mbrojtjes së diplomës Fakulteti i Shëndetit Publik
109	4.17	Shembull i trajtimit të ankesave akademike të studentëve
110	4.43	Botimet e Universitetit
111	1.3	Vendimi për ndryshimet e Rregullores
112	1.4	Mbrojtja e të dhënave
113	1.5	Ndryshimet në statute
114	1.8	Kodi i Etikës
115	1.9	Rregullorja e Senatit Akademik
116	1.13	Buxheti për vitin 2012
117	1.15	Struktura e vjetër
118	1.17	Spektori i projektit
119	1.20	Vendimi nr. 78
120	1.21	Raporti vjetor
121	1.22	Kualifikimet e stafit akademik të Universitetit të Vlorës
122	1.23	Kriteret e pranimit
123	1.24	Cikli i procedurës së programit
124	1.26	Procedura e mbrojtjes së tezës
125	1.27	Procedura për programet doktorale

126	1.28	Raporti vjetor i FSHP-së për vitin 2016
127	1.29	Analiza e kërkesës së tregut
128	1.30	Stafi (akademik dhe joakademik)
129	1.31	Lista e projekteve të granteve të BE-së
130	1.32.1	Marrëveshje, studentë dhe staf akademik
131	1.35	Projektet ERASMUS
132	1.36	Lista e marrëveshjeve profesionale të FSHP-së
133	1.37	Akademikë të huaj
134	2.10	Buxheti për vitin 2016
135	2.11	Buxheti i hartuar për vitin 2017
136	2.20	Memorandum marrëveshjeje
137	3.3	Projekti AMICI i Ditës së Informacionit
138	3.4	Fillimi i UV
139	3.7	Plan projekti
140	3.8.1	Raporti vjetor
141	3.12	Studim me korrespondencë
142	3.14	Strategjia e njësive të ndryshme
143	3.19	Shpërndarja e orëve
144	3.20	Pagesa e punës jashtë orarit
145	3.21	Marrëveshje për ngarkesën vjetore të punës
146	3.22	Marrëveshja për ngarkesën vjetore me IAL publik
147	3.31	Përfaqësues të fushave të biznesit
148	4.1	Rregullorja e Fakultetit të Shëndetit Publik (FSHP) 2017
149	4.1.1	Rregullorja e Departamentit të Kujdesit Shëndetësor
150	4.2	Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Teknike (FSHT) 2015
151	4.3	Procesi i përmirësimit të kurrikulës, shembull FSHP
152	4.6	Fakulteti i Shkencave Teknike, raporti i veprimtarisë vjetor 2014
153	4.8	Shembull, Zhvillimi i kursit të praktikës profesionale - Praktika DET325 Lundrimore - Shkencat Detare
154	4.9	Shembull i vlerësimit të praktikës profesionale, Fakulteti i Shëndetit Publik
155	4.11	Procedura e Mbrojtjes së Diplomës Master i Shkencave, Fakulteti i Shkencave Teknike
156	4.15	Procedura e miratimit të syllabusve FE
157	4.16	Programi i lëndës, shembull i Fakultetit të Shëndetit Publik
158	4.18	Modelet e raportimit për kërkimin shkencor
159	4.19	Departamenti i Strategjisë Infermierore, Fakulteti i Shëndetit Publik
160	4.20	Përshtatja e kurrikulave për tregun e punës, kërkesa për gjuhën gjermane, FPH
161	4.21	Rregullore e Qendrës së Kërkimit Shkencor të UV
162	4.22	Vendimi nr. 81 Transformimi i njësisë bazë në qendrën kërkimore, FSHP
163	4.24	Qendra e Kërkimit për Strategjinë e Shëndetit Publik
164	4.26	Vendimi nr. 79 datë 12.12.2016
165	4.27	Projektbuxheti i Departamentit të Infermierisë FSHP
166	4.29	Vendim për miratimin e planit buxhetor
167	4.30	Vendimi nr. 87
168	4.34	Projekte kërkimore Fakulteti i Shëndetit Publik
169	4.35	Konferencat dhe seminarët UV 2014-2017
170	4.36	Vendimi nr. 86
171	4.37	Vendimi për të dhënë titullin Doktor "honoris causa"

172	4.38	Vendimi për kriteret e përzgjedhjes për pozicionet akademike me kohë të plotë në UV për vitin 2015
173	4.39	Vendimi për kriteret e përzgjedhjes për pozicionet akademike me kohë të plotë në UV për vitin 2013
174	4.40	Grupet mësimore dhe kërkimore të Departamentit të Gjuhëve të Huaja
175	4.41	Grupet mësimore dhe kërkimore të Fakultetit të Shëndetit Publik
176	4.42	Lista e lektorëve të UV që japin mësim jashtë vendit
177	4.44	Botime të Fakultetit të Shkencave Humane
178	5.1	Marrëveshja e Drejtorisë Arsimore Rajonale me Institucionin
179	5.1.1	Marrëveshja e Drejtorisë Arsimore Rajonale në vite të ndryshme
180	5.2	Raporti pedagog-student
181	5.4	Vendimi nr. 50 "Kriteret e miratimit për pranimin e kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve për vitin akademik 2016/2017"
182	5.5	Përgjigje nga Ministria e Arsimit
183	5.7	Udhëzimi i Rektorit nr. 1586, datë 21.11.2016
184	5.14	Veprimtaria e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni për vitin akademik 2014-2015
185	5.15	Baza e të dhënave për alumni
186	5.16	Organizimi i panairit të punës në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë
187	3.5.1	Kriteret e pranimit

Dokumente të mëtejshme (FE)

Renditja	Nr. i dokumentit	Titulli
1		Përgjigje ndaj kërkesës për dokumente shtesë
2	1.1.1	Shpjegimi i tendencave të numrit të studentëve
3	1.1.2	Shpjegimi i ndryshimit të numrit të stafit të ftuar
4	1.1.3	Shpjegimi për ndryshimet në numrin e studentëve të dërguar tek institucionet partnere (2014-15 deri 2016-17)
5	1.2	Struktura aktual e komisionit të Universitetit
6	1.3 a	Organigrama aktuale e Universitetit (akademike)
7	1.3 b	Organigrama aktuale e Universitetit (administrative)
8	1.4	Shembull i një skeme grafike organizative aktuale të fakultetit që tregon rolet kryesore dhe komisionet dhe drejtimet e raportimit
9	1.5	Strategjia e ndërkombëtarizimit
10	1.6	Raporti Vjetor 2016
11	1.7	Dëshmi e kërkimit të tregut
12	1.8	Dëshmi lidhur me caktimin e praktikës profesionale, shërbimet dhe përkrahjen e ofruar nga institucionet partnere
13	1.9	Dëshmitë e punësimit të të diplomuarve
14	1.10a	Marrëveshja e partneritetit - shembull
15	1.10b	Shkëmbimet Erasmus
16	1.10c	Lista e marrëveshjeve të partneritetit
17	2.5	Plan Projekti (dokument RVV 3.7) në gjuhën angleze
18	2.6	Shpjegimi i statusit të Planit Strategjik
19	2.7	Certifikatat e shëndetësisë dhe sigurisë dhe dëshmi të tjera të

		ambienteve në përputhje me rregulloret e ndërtesave
20	3.1	Dokument qëndrimi në lidhje me regjistrimin e studentëve të huaj
21	3.2	Llogaritja e ngarkesës së stafit akademik
22	3.4	Botimet e studentëve
23	4.1	Bordi Këshillimor
24	4.2	Procesverbali i Senatit
25	4.3	Evidenca të punës së Zyrës së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
26	4.5 a	Shembulli 1 - strategjitë e zhvillimit të miratuara nga njësitë kryesore dhe njësitë bazë
27	4.5 b	Shembulli 2 - strategjitë e zhvillimit të miratuara nga njësitë kryesore dhe njësitë bazë
28	4.6	Rregullorja e Fakultetit të Shëndetit Publik
29		Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Teknike
30		Propozimi i ristrukturimit të kurrikulës
31		Dokumentacioni i akreditimit
32	4.7	Miratimi i Raportit Vjetor 2014
33	4.8	Procesverbalet e Rektoratit
34	4.9	Raport mbi veprimtarinë e Fakultetit të Shëndetit Publik
35, 36	4.10	Dëshmitë e veprimtarisë së studimit të tregut
37	4.11	Gjurmimi i studentëve pas diplomimit
38	4.12	Institucionet partnere sipas programit
39	4.13	Evidencë për të treguar se fletët e provimit do të sekretohen gjatë korrigjimit
40	4.15	Artikuj në revista shkencore me vlerësim të jashtëm nga ekspertë të së njëjtës fushë (<i>peer-review</i>) nga stafi i UV në vitin 2015-17
41	4.16	Pjesëmarrja e stafit në konferenca jashtë shtetit
42	5.2	Kuota për studentët romë/egjiptianë

Dokumente shtesë (AE)

Renditja	Nr. i dokumentit	Titulli
1		Grafiku i vizitës së vlerësimit
2		Hartimi i strategjisë universitare 2017-2024
3		Vendimi i Senatit Akademik për rritjen e numrit të stafit
4		Funksionet dhe struktura e Njesisë së Sigurimit dhe Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë
5		Funksionet dhe Struktura e Zyrës për të Mësuarit gjatë Gjithë Jetës
6		Kriteret për emërimin e stafit të ri
7		Botimet e studentëve
8		Shembull i Strategjisë së Departamentit
9		Shembull i strategjisë së Fakultetit
10		Shembull i hapësirës që përdoret në organizata të tjera
11		Politika e Tutoratit
12		Kurse trajnimi
13		Raporti i veprimtarive të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Njesisë së Akreditimit
14		Rregullorja e Universitetit mbi kopjimin në provime
15		Udhëzime për studentët në lidhje me kopjim në provime

16		Shembull i ndryshimit të kurrikulës
17		Raport Vetëvlerësimi për Departamentin e Shkencave Kompjuterike
18		Raporti i auditimit të brendshëm (sipas strukturës së re)
19		Raporti i auditimit të brendshëm (sipas strukturës së mëparshme)
20		Shembull i mbylljes së programit
21		Vendimet e Senatit
22		Ngarkesa e punës bazuar në direktivën 20 të MAS-së

Mbledhjet

- M1 Mbledhja 1
- M2 Mbledhja 2
- M3 Mbledhja 3
- M4 Mbledhja 4
- M5 Mbledhja 5
- M6 Mbledhja 6
- M8 Mbledhja 8
- M9 Mbledhja 9